




Funded by
the European Union

RRJETET SOCIALE



KU URREJTJA VËRSHON E PAPENGUAR

ANALIZË E PRIRJEVE KRYESORE TË GJUHËS SË URREJTJES,
GJUHËS OFENDUESE E TË PAPËRSHTATSHME KUNDËR
PERSONAVE LGBTIQ+.

IMPLEMENTED BY:



CEL
CENTRE FOR EQUALITY
AND LIBERTY | K O S O V A

QENDRA PËR BARAZI DHE LIRI TË KOMUNITETET LGBT NË KOSOVË (CEL)

AUTORE: AULONË KADRIU

AULONË KADRIU ËSHTË HULUMTUESE, SHKRIMTARE DHE REDAKTORE. AKTUALISHT PUNON SI REDAKTORE E LARTË NË REVISTËN KOSOVO 2.0. TASH E MBI 10 VJET ËSHTË E PËRFSHIRË NË ORGANIZATA, MENTORIM, HULUMTIM DHE NISMA NË FUSHAT E GJINISË DHE SEKSUALITETIT, TË DREJTAVE LGBTIQ+, TË DREJTAVE TË MINORITETEVE, SHKRIMIT KRIJUES, MEDIAS DHE DREJTËSISË SHOQËRORE. KA STUDIAR PËR SHKENCË POLITIKE DHE GJINI, GRA DHE SEKSUALITET, ME VËMENDJE NË RAPORTIN E GJINISË ME LUFTËN DHE NACIONALIZMIN, MASKULINITETIN E NGURTË DHE TË DHUNSHËM.

COPYRIGHT © CENTRE FOR EQUALITY AND LIBERTY TË GJITHA TË DREJTAT E REZERVUARA. ASNJË PJESË E KËTIJ PUBLIKIMI NUK MUND TË RIPRODHOHET, TË RUHET OSE TË TRANSMETOHET NË ÇFARËDO FORME ELEKTRONIKE, MEKANIKE FOTOKOPJUESE, INCIZUESE APO NDRYSHE, PA LEJEN PARAPRAKE TË CEL KOSOVA.

CEL. Tel: +383 49 701 499

e-mail: info@cel-ks.org

web-page: www.cel-ks.org

Klauzola e përgjegjesisë

Ky publikim u financua nga Bashkimi European. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e CEL Kosova dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit European.

TABELA E PËRMBAJTJES

I. Rreth kësaj analize	4
I.I Për çka është kjo analizë?.....	4
I.II Pse kjo analizë?.....	7
I.III Çka është kjo analizë?.....	7
I.IV Si u bë kjo analizë?.....	9
II. Rregullimi i përmbajtjeve mediale në Kosovë	12
II.I Mekanizmat rregullues dhe vetërregullues të medieve në Kosovë.....	12
II.II Komentet: Zonë e përhimtë.....	15
III. Për çka dhe si u fol, kur u fol për personat/të drejtat/çështjet LGBTQ+ në Kosovë gjatë vitit 2024?	17
III.I Kodi Civil.....	18
III.II 17 maji, mundësi e humbur për t'i vënë në pah përvojat LGBTQ+.....	22
III.III Parada e Krenarisë, lajme shumë, në një ditë të vetme.....	23
III.IV Njerëzit trans, veçanërisht të përjashtuar në internet.....	25
III.IV. I Edona James dhe Big Brother VIP Kosova.....	25
III.IV.II Një olimpiane që shpërfaqti raportimin e pandjeshëm.....	28
IV. Çështjet tjera ku u manifestua homotransfobia në internet	29
IV.I Homofobi kundër njerëzve në politikë.....	29
IV.II Ligje të instrumentalizuara për homotransfobi.....	30
IV.III Të refuzuarit/at e Eurovision.....	30
IV.IV Një marrëveshje që çoi pluhur.....	31
IV.V Homotransfobi për shkak të deklaratave, dukjes, zgjedhjeve e karakteristikave tjera.....	32
V. Përfundim	33
V.I Në vend të rekomandimeve.....	34
V.I.I Për mediet dhe gazetarët/et e hapur/a për ndryshim.....	34
V.I.II Për mekanizmat rregullues dhe vetërregullues të medieve.....	35
V.I.III Për komunitetin e donatorëve.....	36

I.RRETH KËSAJ ANALIZE

I.I PËR ÇKA ËSHTE KJO ANALIZË?

Liria e personave LGBTIQ+ në Kosovë ndrydhet e kufizohet përditë.[1] Kjo shtypje manifestohet sidomos në disa mënyra, veprime e mungesë të veprimeve. Së pari, kjo shtypje sendërtohet në mungesë të politikave të mirëqenies që u shërbejnë barabartë personave LGBTIQ+ e që i marrin përbazë sfidat historike me të cilat janë përballur personat LGBTIQ+ ndër vite.

Së dyti, manifestohet me mosveprim, kur institucionet gjegjëse, sidomos ato të sigurisë e drejtësisë, nuk janë të gatshme t'ua zgjasin personave LGBTIQ+ bujarinë që Kushtetuta, ligjet, politikat aktuale në Kosovë ua premtojnë qytetarëve të vet; nuk tregojnë gatishmëri të reagojnë shpejt dhe me ngulm për t'i mbrojtur personat LGBTIQ+ përballë rreziqeve, që rrjedhin nga homostransfobia e urrejtja.

Së treti, manifestohet kur përfaqësuesit/et, që bartin pozita të pushtetshme rezistojnë t'i njohin individët LGBTIQ+ is qytetarë për të drejtat e të cilëve ia vlen të punohet, për mirëqenien e të cilëve duhet përkushtuar kohë e burime. Ata refuzojnë të flasin për individët LGBTIQ+, të tregojnë vendosmëri në mbrojtjen e tyre, të jenë të qartë në përpjekjet e tyre — refuzojnë t'i përmendin njerëzit LGBTIQ+.

Manifestohet kur qeveritë sillen sikur njerëzit LGBTIQ+ nuk ekzistojnë; kur ato përpiqen që njerëzit LGBTIQ+ përpiqen t'i shtyejnë larg syve, larg vëmendjes publike. Kështu, qytetarët LGBTIQ+ shtyhen në skaj të qytetarisë, të përkatësisë, të të qenit të perceptuar si mjaftueshëm të denjë për të gëzuar të drejtat e obligimet që rrjedhin nga të qenit qytetar.

Pastaj, manifestohet përmes gjuhës dhe mungesës së saj. Dhe gjuha në vetvete nuk funksionon e shkëputur prej formave tjera se si qytetarët LGBTIQ+ shtypen. Ajo ndërthuret dhe e ndihmon shtypjen, fjalët bëhen mjete[2] përmes së cilave sendërtohet shtypja dhe mosnjohja. Por, po aq sa instrumentalizimi i fjalëve mund të jetë shtypës, mungesa e tyre mund të jetë po aq mjet i fuqishëm që e përparon dhe e formëson shtypjen.

Heshtja apo mungesa e dëshirës për t'i njohur rrëfimet LGBTIQ+ dhe të vërtetën e tyre, po ashtu kontribuon në fshirje të rrëfimeve LGBTIQ+; në fshirje të përjetimeve të tyre; në harresë rreth ekzistencës së tyre. Por mbi të gjitha kontribuon në moskërkim të llogaridhënies për abuzimet, shtypjet dhe padrejtësitë ndaj tyre.

1.Kosovo 2.0, Querness është këtu për të qëndruar, Një dekadë përmbajtjes LGBTIQ+. Për herë të fundit qasur më 21 nëntor.
<https://kosovotwopointzero.com/querness-eshte-ketu-per-te-qendruar/>

2.Shih: Sara Ahmed, Living a Feminist Life, United Kingdom: Duke University Press, 2017.

Pa fjalë, problemet mund të mbesin pa emër, të paregjistruara[3] e përfundimisht të pazgjidhura. Pos kësaj, nëse personat LGBTQ+ nuk janë asnjëherë në medie, apo janë rrallë në to, prania e tyre do të mbetet e çnormalizuar, e pazakontë, e herë-herë, siç është parë në këtë analizë, do të shihet si patologjike. Kësisoj, duke mos shkruar për e duke mos i përfaqësuar personat/të drejtat LGBTQ+, mediet mund të ndihmojnë në krijimin e një ambienti digjital ku vërshon urrejtja e gjuha përjashtuese në momentet e pakta kur personat LGBTQ+ shfaqen në medie.

Kësisoj, detyra e medias është të sigurohet që problemet të kenë emra dhe pastaj, të sigurohet që përcjell deri në fund e me vigjilencë zgjidhjet e atyre problemeve. Ato bartin përgjegjësinë për të ushqyer kureshtjen dhe dëshirën për të vërtetën, si dhe për t'i shërbyer interesit publik — duke pasur një të kuptuar gjithpërfshirës rreth asaj se kush është publiku, kush janë qytetarët.

Po ashtu, përmes raportimit të drejtë, përfaqësues e të ndjeshëm, media luan rol të rëndësishëm në reduktimin dhe zhbërjen e urrejtjes ndaj qytetarëve LGBTQ+. Ky reduktim ndodh së pari duke pasur medie të vëmendshme ndaj gjuhës së urrejtjes, gjuhës së papërshtatshme, gjuhës nxitëse, përçarëse ndaj personave LGBTQ+. Me pjesën e fundit merret kjo analizë, por assesi vetëm me të, sepse analiza është ndërtuar mbi premisën që fjalët janë përbërës të rëndësishëm të shtypjeve sistemike ndaj personave LGBTQ+.

Duke qenë se mungon një përkufizim i pranuar universalisht dhe i rregulluar përmes ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriu[4] *përkufizimi i asaj se çka përbën gjuhë të urrejtjes mbetet detyrë e vështirë dhe e pazgjidhur ende*[5], gjatë analizës së përmbajtjeve për këtë tekst, si dhe gjatë shkrimit të tij, janë marrë për bazë përkufizime të përafuara nga Këshilli i Evropës, Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) dhe institucione tjera të rëndësishme. Po ashtu, analiza shfrytëzon përkufizimet e ofruara nga legjislacioni në Kosovë, të cilat mund të jenë relevante dhe të dobishme në leximin e kësaj analize.

Pos kësaj, analiza merr për bazë rëndësinë qendrore të lirisë së shprehjes, siç rregullohet në Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut, si dhe kufizimet që vijnë me të.[6] Ky instrument është po ashtu i zbatueshëm në Kosovë sipas Kushtetutës së Kosovës.[7]

3.Shih: Sara Ahmed, *Complaint!*, United Kingdom: Duke University Press, 2021

4.Zyra e Komisionerit të Lartë, Organizata e Kombeve të Bashkuara, Ligji Ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut, një histori e shkurtër. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. <https://www.ohchr.org/en/what-are-human-rights/international-bill-human-rights>

5.ARTICLE 19, 'Hate speech' explained: A summary, [article19.org](https://www.article19.org), 7 dhjetor 2020. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. <https://www.article19.org/resources/hate-speech-explained-a-summary/>

6.Equality and Human Rights Comission, Article 19: Freedom of Expression, [equalityhumanrights.com](https://www.equalityhumanrights.com), 3 qershor 2021. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. <https://www.equalityhumanrights.com/human-rights/human-rights-act/article-10-freedom-expression>

7.Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, [gzk-rks.gov.net](https://gzk.rks.gov.net), 9 prill 2008. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. <https://gzk.rks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

Kështu, sipas rekomandimit CM/Rec (2022)16 të Komitetit të Ministrave, të Këshillit të Evropës, drejtuar shteteve anëtare të Bashkimit Evropian[8], gjuhë e urrejtjes kuptohet si secila formë e shprehjes që nxit, promovon, shpërndan ose justifikon dhunën, urrejtjen ose diskriminimin kundër një personi apo një grupi personash, ose që i denigron ata/o, për shkak të karakteristikave të tyre të njëmendëta apo të atribuara apo statusit siç është raca, ngjyra, gjuha, religjioni, kombësia, origjina etnike apo kombëtare, mosha, aftësia e kufizuar, seksi, identiteti gjinor dhe orientimi seksual.

Sipas OKB, gjuhë e urrejtjes është çfarëdo komunikimi, në të folur, shkruar apo në sjellje, që sulmon ose përdor gjuhë pezhorative ose diskriminuese duke iu referuar një personi ose grupi në bazë të asaj që ata/o janë, me fjalë tjera, bazuar në fenë e tyre, etninë, kombësinë, racën, ngjyrën, prejardhjen, gjininë apo ndonjë faktor tjetër identiteti[9].

Ndërkohë, sipas Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike[10], neni 20, paragrafi 2, parasheh që çdo avokim i urrejtjes kombëtare, racore apo fetare që përbën nxitje të diskriminimit, armiqësisë ose dhunës duhet të dënohet me ligj. (shih dhe Planin e Veprimit Rabat)[11].

Gjuha e urrejtjes është e dënueshme edhe në Kosovë. Kodi Penal, neni 141, pika 1, thotë: "Kushdo që nxit ose përhap publikisht urrejtje, përçarje dhe mos durim midis grupeve kombëtare, racore, fetare, etnike e të tjera, apo bazuar në orientimin seksual, identitetin gjinor dhe karakteristikat e tjera personale, në mënyrën e cila mund të prishë rendin publik dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë (5) vjet." [12]

Po ashtu, në këtë analizë merren për bazë tri llojet e shprehjes[13] a) shprehja që përbën shkelje nën ligjin ndërkombëtar dhe mund të ndiqet penalisht; b) shprehja që nuk është penalisht e dënueshme, por mund të justifikojë një kufizim apo padi civile dhe c) shprehja që nuk justifikojn dënime penale apo civile, por prapëseprapë ngirisn shqetësime sa i përket tolerancës, mirësjelljes dhe respektit për të tjerët.

8.Këshilli i Evropës, Komiteti i Ministrave, Rekomandimi CM/Rec(2022)16 i Komitetit të Ministrave për vendet anëtare rreth luftimit të gjuhës së urrejtjes, 20 maj 2022. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. <https://search.coe.int/cm/#{%22CoEIdentifier%22:%220900001680a67955%22,%22sort%22:%22CoEValidationDate%20Descending%22}>

9.Kombet e Bashkuara, Understanding Hate Speech (Të të kuptuarit e gjuhës së urrejtjes), un.org, pa datë publikimi. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. <https://www.un.org/en/hate-speech/understanding-hate-speech/what-is-hate-speech>

10.Kombet e Bashkuara, Instrumentet e të drejtave të njeriut, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, adoptuar më 16.12.1966, ohchr.org. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/international-covenant-civil-and-political-rights>

11. Kombet e Bashkuara, Plani i Veprimit Rabat, publikuar më 5 tetor 2012, ohchr.org. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. <https://www.ohchr.org/en/documents/outcome-documents/rabat-plan-action>

12.Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Kodi nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, gzk-rks.gov.net. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18413>

13.Kombet e Bashkuara, Asambleja e Përgjithshme, Seanca e gjashtëdhjetëgjashtë, Promovimi dhe mbrojtja e së drejtës për liri të medimit dhe shprehjes, 10 gusht 2011, ohchr.org. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. <https://www.ohchr.org/sites/default/files/Documents/Issues/Opinion/A.66.290.pdf>

Në këtë analizë po ashtu përdoret termi gjuhë homotransfobike apo homotransfobi. Ky term është një përbashkim i dy termeve: homofobi, që do të thotë[14], ndër tjera, diskriminim kundër, aversion ndaj, ose frikë nga homoseksualitetit apo njerëzve gay dhe termit transfobi që do të thotë[15] diskriminim kundër, aversion ndaj, ose frikë nga njerëzve trans.

Anipse në këtë anaalizë përdoret shpesh termi "homotransfobi" bashkë me termin "urrejtje", "gjuhë të urrejtjes", kjo nuk do të thotë se homotransfobia nuk është urrejtje. Është përzgjedhje gjuhësore për ta komunikuar sa më qartë nivelin e urrejtjes ndaj njerëzve LGBTIQ+.

I.II PSE KJO ANALIZË?

Centre for Equality and Liberty (CEL) realizoi këtë analizë në vazhden e përpjekjeve të veta për drejtësi për qytetarët LGBTIQ+. Për CEL, vërshimi i internetit me gjuhë të urrejtjes, gjuhë fyese, përjashtuese e të papërshtatshme kontribuon në normalizim të urrejtjes edhe tjetërkund, jashtë internetit, dhe e përkeqëson drejtpërsëdrejti mirëqenien e personave LGBTIQ+[16].

Prandaj, është qenësore që të merren vesh prirjet e gjuhës homotransfobike, të urrejtjes, gjuhës fyese e poshtëruese, ashtu që të dihet më mirë se si ta kundërshtojmë këtë gjuhë.

Ndoshta kjo analizë do të bëjë vend për aleanca të reja për drejtësi apo ndoshta do të shërbejë si çast reflektimi e edhe zotimi për entitetet mediale, përdoruesit e rrjeteve sociale, institucionet përkatëse, që të kërkojnë e të punojnë më me ngulm drejt një ambienti online më mirëpritës, ku ndodhin diskutime në vend të kërcënimeve e urrejtjes e ku zënë vendin që u takon edhe rrëfimet e përjashtuara të njerëzve LGBTIQ+.

Si rrjedhojë, kjo analizë është edhe thirrje për mobilizim për drejtësi në internet e tjetërkund, e edhe shprehje e vullnetit të CEL për t'i ndihmuar cilitdo entitet që dëshiron të bashkohet në këtë përpjekje.

I.III ÇKA ËSHTË KJO ANALIZË?

Kjo analizë është vështrim, përcjellje dhe interpretim i gjuhës së përdorur në internet, duke u përqendruar në një numër portalesh dhe seksionet e komenteve në Kosovë. Në thelb, kjo është një analizë diskursi me përqendrim në gjuhën e përdorur ndaj personave LGBTIQ+, si dhe mënyrën e mbulimit të çështjeve, që lidhen drejtpërdrejt me njerëzit dhe të drejtat LGBTIQ+.

14.Marriam-Webster, kuptimi i fjalës: homophobia. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. <https://www.merriam-webster.com/dictionary/homophobia>

15.Marriam-Webster, kuptimi i fjalës: transphobia. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. <https://www.merriam-webster.com/dictionary/transphobia>

16. Këshilli i Evropës, Çka është gjuha e urrejtjes dhe pse është problem?, pa datë publikimi, coe.int. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. <https://www.coe.int/en/web/combating-hate-speech/what-is-hate-speech-and-why-is-it-a-problem->

Më saktësisht, CEL ka përcjellur dymbëdhjetë (12) portale lajmesh ditore, që operojnë në Kosovë. Këto portale janë zgjedhur për këto arsye: ose për shkak të numrit të lartë të ndjekësve; numrit të lartë të lajmeve të publikuara për ditë; numër i madh i komenteve. CEL nuk ka nxjerrë a realizuar ndonjë hulumtim për lexueshmërinë e portaleve, megjithatë ka marrë përbazë raporte të publikuara prej entiteteve tjera, që sugjerojnë se cilat portale janë më të lexuara.

Disa portale janë analizuar në bazë të rekomandimit të CEL — ato portale që kanë qenë sidomos problematike; ato portale që kanë shfaqur përpjekje për të mbuluar çështjet që lidhen me të drejtat a njerëzit LGBTQ+; ato portale, që kur kanë postuar një lajm të caktuar, kanë ndikuar në mënyrën se si është folur për njerëzit LGBTQ+.

Disa portale janë zgjedhur për ndikimin që e kanë në diskursin publik, pra, sa na është dukur neve — CEL dhe autores — se kanë arritur që ngjarjet, lajmet e prodhuara nga këto portale të ndikojnë në atë se çka flitet gjerësisht apo çka bëhet çështje në diskutim publik.

CEL ka analizuar këto 12 portale në disa rrafshë: a) mënyrën se si këto portale kanë mbuluar çështjet LGBTQ+; b) nivelin e mbulimit të çështjeve LGBTQ+; c) mënyrën se si është komentuar në lajmet e postuara në rrjetin social Facebook të këtyre portaleve; d) a i kanë larguar komentet me gjuhë urrejtjeje; përjashtuese e homotransfobike.

Janë zgjedhur postimet dhe seksionet e komenteve në rrjetin social Facebook për shkak të nivelit të lartë të përdorimit të tij, qoftë prej portaleve, qoftë prej përdoruesve, dhe nivelit relativisht të ulët të përdorimit të rrjeteve tjera sociale. Më saktësisht sipas Statista, platformë gjermane, që specializon në mbledhje të të dhënave, në të dhënat e mbledhura në prill 2024, del se Facebook është rrjeti social më i madh, me numrin më të madh të përdoruesve aktivë për muaj. Facebook, për muaj, ka mesatarisht 3.7 bilionë përdorues.[17]

Ndërkohë, sipas të dhënave të DigitalReportal, që mbledh të dhëna në nivel botëror për përdorimin e internetit, në fillim të vitit 2024, Kosova kishte rreth 885,900 përdorues[18] të Facebook. Facebook po ashtu vazhdon të jetë vendi kryesor[19] për të marrë lajme.

17.Stacy Jo Dixon, Rrjetet sociale më të njohura botërisht deri në prill 2024, bazuar në numrin e përdoruesve aktivë mujorë (në miliona), Statista, 10 korrik 2024, proxy.parisjc.edu. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024

18.Simon Kemp, Digital 2024: Kosovo, Datareportal, 23 shkurt 2024, detareportal.com. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. <https://datareportal.com/reports/digital-2024-kosovo>

19.Heather Kelly, From TV to TikTok, how we get the news is changing fast (Nga TV te TikTok, mënyra si i marrim lajmet po ndërron shpejt), The Washington Post, 15 nëntor 2023, washingtonpost.com. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. <https://www.washingtonpost.com/technology/2023/11/15/news-trends-social/>

Në fund, kjo analizë nuk do të sjellë të dhëna statistikore, sa do të sjellë prirjet rreth raportimit LGBTQ+. Do të përpiqet t'u përgjigjet pyetjeve: Çka u shkrua rreth personave/të drejtave/çështjeve LGBTQ+, cilat ngjarje patën ndikim, çka u komentua rreth personave/të drejtave/çështjeve LGBTQ+, cilat ngjarje, njerëz, dukuri u komentuan e mbuluan më shpesh, sidomos me gjuhë urrejtjeje, fyese, poshtëruese dhe kur dhe si u fol për personat/të drejtat/çështjet LGBTQ+.

I.IV SI U BË KJO ANALIZË?

CEL ka përcjellur faqet në Facebook të portaleve të zgjedhura duke kërkuar përmbajtje me fjalë të caktuara, si dhe duke analizuar përmbajtjen tërë-ditore në ditë të caktuara për vitin 2024.

Pra, CEL përmes opsionit për filtrim në Facebook, ka përcjellur të gjitha lajmet e publikuara në data si: 17 maj, Dita Ndërkombëtare Kundër Homofobisë, Bifobisë dhe Transfobisë; 3 qershori, dita e fillimit të Javës së Krenarisë; 8 qershori, dita e mbajtjes së Paradës së Krenarisë. Për këto data, CEL ka shikuar të gjithë përmbajtjen e publikuar — portalet e përcjellura, secila publikojnë prej 40 deri në mbi 100 postime përditë — dhe ka nxjerrë përmbajtjet (nëse ka pasur) që janë lidhur me të drejtat LGBTQ+.

Po ashtu, CEL ka analizuar përmbajtje/postime (nganjëherë postimet kanë qenë vetëm në rrjetin social Facebook si fotografi me mbishkrim apo video, pa pasur përmbajtje përcjellëse në ueb) që kanë dalë si rezultate pas kërkimit të fjalëve kyçe.

Fjalët kyçe që ka përdorur CEL për të kërkuar përmbajtje kryesisht kanë qenë: gay, lezbike, transgjinnor/e, orientim seksual, LGBT/LGBTQ/LGBTIQ, Kodi Civil, si dhe bazuar në gjetjet preliminare, që kanë treguar për përdorim të shpeshtë të këtyre fjalëve — CEL për kërkim ka përdorur disa fjalë përcmuese dhe diskriminuese ndaj personave LGBTQ+. CEL ka përdorur edhe fjalë të tjera — për shembull “prindi 1, prindi 2, Java e Krenarisë, Parada e Krenarisë”, për t'u siguruar sa më shumë që postimet/ngjarjet me rëndësi të mos përvidhen.

Marrë parasysh që jo secili rezultat që ka dalë pas kërkimit ka qenë relevant, CEL ka zgjedhur përmbajtjet që: ose kanë të bëjnë drejtpërdrejt me personat/të drejtat/çështjet LGBTQ+, ose kanë qenë relevante për këtë analizë për tjera arsye: kanë përmbajtur numër të madh komentesh, që kanë shpërfaqur gjuhë urrejtjeje, gjuhë të papërshtatshme e diskriminuese ndaj personave LGBTQ+. Pra, në thelb, CEL ka parë qindra-mijëra postime/përmbajtje. Vëmendje e veçantë u është kushtuar sidomos rasteve kur në shpërndarjen e gjuhës së urrejtjes, apo diskriminuese, apo të papërshtatshme, apo dezinformuese janë përfshirë përfaqësues/e institucionalë/e a figura politike e publike.

Kësisoj, në bazë të këtyre filtrave, CEL ka analizuar më për së afërmi dhe ka krijuar një databazë me rreth 340 postime/përmbajtje në portale. Këto postime kanë pasur gjithsej 27,710 komente — shumica, por jo domosdo të gjitha, kanë qenë të lidhur me personat/të drejtat/çështjet LGBTQ+.


Lexuesi/ja i/e kësaj analize duhet të marrë parasysh mundësinë që një njeri mund të ketë hapur më shumë se një llogari e mund të jetë prapa më shumë se vetëm një komenti. CEL nuk ka analizuar vërtetësinë e secilit komentues veç e veç, por ka analizuar përmbajtjen që është plasuar në internet. Po ashtu, lexuesi/ja e kësaj analize duhet të dijë që anipse në këtë analizë, CEL është përpjekur të mos kopjojë fjalë për fjalë komentet urryese, shtypëse e përjashtuese, në mënyrë që të mos u krijojë më shumë vend atyre, prapëseprapë do të përmenden prirjet, narrativat kryesore që mbizotëruan në mediet/postimet/komentet e analizuar.

Po ashtu, rreth 100 prej përmbajtjeve/postimeve të analizuar janë mbledhur jo pse përmbajtjet përmendin çështje që lidhen drejtpërdrejt me të drejtat LGBTQ+ apo se përmendin personat apo qoftë ndonjë nga fjalët në akronimin LGBTQ+, por sepse komentet kanë qenë kryesisht të orientuara kundër të drejtave/çështjeve/personave LGBTQ+. Pra, do të thotë se CEL ka arritur t'i nxjerrë diku 240 përmbajtje si përmbajtje që kanë përmendur persona/të drejta/çështjet LGBTQ+ në një formë a tjetrën.

Nëse marrim për bazë faktin që portalet e analizuar postojnë prej 40 deri në 100 artikuj përditë (ka pasur portale me më shumë postime se 100) — i bie se për 358 ditët që kanë kaluar deri më 10 nëntor, kur përfundon analiza, janë bërë rreth 14,320 më së paku, e deri 35,800 postime për portal, që në total i bie se janë bërë prej 171,840 deri 429,600 postime në total nga 12 portale. Kjo i bie se përmbajtjet rreth njerëzve/çështjeve/të drejtave LGBTQ+ përbëjnë më pak se 1% të të gjitha përmbajtjeve të botuara.

Nëse e marrim se portalet kanë publikuar numrin minimal të postimeve - 40


Rreth/relevante për LGBTQ+
0.1%



Të gjitha postimet/përmbajtjet
99.9%

Nëse e marrim se portalet kanë publikuar numrin minimal të postimeve - 100

Rreth/relevante për LGBTQ+
0.1%



Të gjitha postimet/përmbajtjet
99.9%

Sa prej të gjithë përmbajtjeve/postimeve në portalet e analizuar kanë qenë rreth njerëzve/çështjeve/të drejtave LGBTQ+.

Normalisht, mund të ketë më shumë artikuj në këto portale — numri i madh i postimeve, por edhe fakti se kjo analizë ka shfrytëzuar kërkime me fjalë të caktuara mund ta rrisin margjinën e gabimeve, por një gjë është e sigurt, për personat/të drejtat/çështjet LGBTIQ+ shkruhet tepër pak dhe kur shkruhet, po ashtu shkruhet tepër shkurt e, jo rrallë, edhe në mënyrë problematike.

CEL ka zgjedhur të mos përmend me emra portalet kryesisht për dy arsye: së pari, përgjithësisht, nuk është se ka vërejtur ndonjë dallim që ia vlen të përmendet midis portaleve dhe së dyti, kjo analizë synon thjesht të vërejë prirjet, kur është fjala për gjuhën e urrejtjes dhe mënyrën e raportimit.

CEL ka vlerësuar se përmendja e emrave të portaleve në këtë kontekst nuk sjellë ndonjë dobi, për më shumë, disave që kanë qenë sidomos strumbullarë të urrejtjes, mund t'u sjell trafik. Prapëseprapë CEL do ta shfrytëzojë këtë analizë dhe databazën e krijuar për këtë analizë, që t'i përcjell këto portale dhe kurdo që ka mundësi e kurdo që e konsideron të nevojshme, të paraqes ankesa pranë mekanizmave përkatës.

Si rrjedhojë, CEL ka realizuar këtë analizë të shkurtër, që megjithatë mund të shërbejë si bazë e mirë për hulumtimet tjera nga entitetet me më shumë burime, njerëzore e financiare, e ekspertizë të specializuar në hulumtim. Mbi të gjitha, mund të shërbejë si material ndihmës për institucionet gjegjëse, vetë mediet, si dhe shoqërinë civile të angazhuar në mbrojtje të të drejtave të njeriut.

Analiza është strukturuar asisoji që flet për mënyrën e rregullimit të medieve të shkruara dhe audiovizive në Kosovë, pastaj gjetjet tregohen përmes çështjeve, sfidave, prirjeve kryesore, që kanë mbizotëruar përgjatë vitit 2024. Pra, do të organizohet në bazë të ngjarjeve që kanë nxitur reagim më të madh publik, e edhe gjuhë të urrejtjes e gjuhë fyese, të papërshtatshme, përjashtuese.

Në këtë analizë mund të përdoret termi gjuhë e urrejtjes, sipas përkufizimeve më lart, dhe terme tjera si gjuhë diskriminuese, problematike, e papërshtatshme, fyese, nxitëse, për të nënkuptuar forma tjera të të shprehurit që mund të mos jenë gjuhë urrejtjeje sipas përkufizimeve, por që megjithatë qartazi synojnë të ofendojnë personat LGBTIQ+ dhe të nënvlerësojnë identitetin e tyre e përfundimisht, në kontekstin edhe ashtu të pabarabartë e shtypës për njerëzit LGBTIQ+ rrezikojnë të mirëmbajnë shtypjen. Mbledhja e artikujve ka mbaruar më 10 nëntor 2024.

II. RREGULLIMI I PËRMBAJTJEVE MEDIALE NË KOSOVË

II.I MEKANIZMAT RREGULLUES DHE VETËRREGULLUES TË MEDIEVE NË KOSOVË

Dy organet më të rëndësishme dhe relevante për këtë analizë, janë Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) dhe Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK).

KPM është organ i pavarur, përgjegjës për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave në Kosovë. KPM licenson transmetuesit publik e privat, përcakton dhe zbaton politikën e transmetimit si dhe rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e personave që ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale — pra televizionet, radiot etj. KPM funksionon sipas legjislacionit përkatës, respektivisht, relevante për këtë analizë: Ligjit Nr.04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave^[20] dhe Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës 2016/03.^[21]

KPM ka kompetencë t'u lëshojë gjoba Ofruesve të Shërbimeve Mediale (OSHM) kurdo që ato dështojnë t'i respektojnë dispozitat ligjore. Për këtë analizë, relevant është sidomos Kodi i Etikës i KPM. Më saktësisht, neni 3 "Përmbajtja fyese dhe e dëmshme", paragrafi 3 i këtij Kodi kërkon nga OSHM që të sigurohen që materiali, i cili mund të shkaktojë dëme, ose përbën shkelje, të justifikohet nga konteksti. "Materialet e tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në, gjuhën fyese, dhunën, seksin, dhunën seksuale, poshtërimin, ankthin, shkeljen e dinjitetit njerëzor, trajtimin ose gjuhën diskriminuese", shkruhet në Kod.

Ndërkohë, sipas nenit 4 për përmbajtjen e dëmshme dhe fyese, paragrafi 3 thotë se në debatet e drejtpërdrejta, OSHM janë të obliguara të ndërmarrin veprimet e duhura për evitimin e përdorimit të gjuhës vulgare ose ofenduese nga pjesëmarrësit. Po ashtu, paragrafi 4 i këtij neni parasheh që gjuha vulgare dhe ofenduese nuk mund të përdoret për transmetim në televizione para kohës së kufizuar (24:00 - 05:00).

Ndërkohë, neni 5 për nxitje të urrejtjes përcakton që OSHM-të që, ndër tjera, orientimi seksual a gjinia nuk duhet përdorur në atë mënyrë që individët të vihen në pozitë denigruese, të pafavorshme, të përqeshen apo tallen. Njëkohësisht, nuk duhet transmetuar përmbajtje programore që nxisin urrejtje mbi bazë të orientimit seksual a gjinisë, duke shtuar se referimet rreth orientimit seksual duhet të bëhen vetëm në rastet kur ky informacion është me rëndësi të drejtpërdrejtë për ngjarjen për të cilën raportohet.

20. Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, 5 dhjetor 2012, gzk-rks.gov.net. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2809>

21. Komisioni i Pavarur i Mediave, Kodi i Etikës për ofruesit e shërbimeve mediale në Republikën e Kosovës, 11 tetor 2016. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. <https://kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Legjislacioni/1476189555.8908.pdf>

KPM ka Departamentin e Monitorimit dhe Analizës, që kryen monitorimin e përmbajtjeve. Monitorimi i përmbajtjeve iniciohet në dy forma: sipas detyrës zyrtare dhe sipas ankesave të palëve — pra, qytetarët po ashtu mund të dërgojnë ankesa[22] në KPM nëse konsiderojnë se një përmbajtje e caktuar është në kundërshti me legjislacionin përkatës.

Në janar të vitit 2024, Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), po ashtu një institucion qenësor kur është fjala për mbrojtjen e të drejtave LGBTQ+ botoi raportin “Gjuha në diskursin publik, në raport me detyrimet që ka shteti në garantimin e lirisë së shprehjes dhe parandalimin e gjuhës së urrejtjes”[23]. Aty, IAP analizon një sërë çështjesh, përfshirë punën e KPM dhe KMSHK dhe numrin e ankesave që kanë marrë ndër vite.

Kur flet për KPM, raporti përmend se në vitin 2020, KPM ka pranuar tri ankesa për gjuhën e përdorur në televizion (jo domosdoshmërisht në lidhje me LBGTIQ+), në vitin 2021, 17 ankesa, asnjëra nga to nuk ka qenë saktësisht për gjuhë të urrejtjes, në vitin 2022, 10 ankesa, por prapë asnjëra nuk ka qenë për gjuhë të urrejtjes. Ndërsa, sipas përgjigjeve të KPM për CEL dhe për analizë, deri më 24 tetor 2024, nuk kanë pranuar asnjë ankesë që lidhet me gjuhë të urrejtjes kundër njerëzve LGBTQ+. CEL ka pyetur edhe IAP për numrin e ankesave. As IAP, deri më 24 tetor, nuk ka pranuar ndonjë ankesë që lidhet me gjuhë të urrejtjes.

Kurse, për mediet e shkruara me rëndësi është Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK)[24], përbërë prej rreth 40 anëtarëve të rregullt që përfshijnë: gazeta, portale dhe agjenci lajmesh. KMSHK, për dallim prej KPM, është organ vetërregullues dhe baza e këtij sistemi është Kodi i Mediave të Shkruara.

Në këtë analizë, relevancë ka sidomos kapitulli 3. Nxitja dhe gjuha e urrejtjes, ku thuhet se shtypi, portalet dhe agjencitë e lajmeve nuk do të nxisin veprime kriminale apo të dhunshme, pavarësisht nga situata apo rrethana; “do të bëjnë të gjitha që munden për të mos nxitur apo ushqyer urrejtje dhe pabarazi përmes: a. Trajtimin me paragjykim të një individi apo grupi mbi baza të përkatësisë etnike, fetare, gjinore, racore, martesore, moshore apo të paaftësisë fizike e mendore; b. Përdorimit të shprehjeve denigruese me qëllim të lëndimit dhe kërcënimit të një individi apo grupi mbi baza të përkatësisë etnike, fetare, gjinore, racore, martesore, moshore apo të paaftësisë fizike e mendore”.

22. Komisioni i Pavarur i Mediave, faqja: ankesat. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. <https://www.kpm-ks.org/ankesa-qdp/286/ankesa-qdp/286>

23. Institucioni i Avokatit të Popullit në Republikën e Kosovës, Raport Ex officio nr. 146/2021 Gjuha në diskursin publik, në raport me detyrimet që ka shteti në garantimin e lirisë së shprehjes dhe parandalimin e gjuhës së urrejtjes, oik-rks.net, 6 shkurt 2024. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. <https://oik-rks.org/2024/02/06/raport-ex-officio-nr-1462021-gjuha-ne-diskursin-publik-ne-raport-me-detyrimet-qe-ka-shteti-ne-garantimin-e-lirise-se-shprehjes-dhe-parandalimin-e-gjuhes-se-urrejtjes/>

24. Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës, Kodi i Mediave të Shkruara të Kosovës. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. https://agk-ks.org/site/assets/files/2614/press-code-for-kosovo_alb_1.pdf

Po ashtu, ngjashëm me Kodin e KPM, ky Kod po ashtu thotë se referencat rreth përkatësisë etnike të një individi, referencat racore, fetare, gjinore, të orientimit seksual apo rreth paaftësisë fizike e mendore do të zhvillohen vetëm në rastet kur informacionet e tilla kanë rëndësi të drejtpërdrejtë për ngjarjen për të cilën raportohet.

KMSHK ka për qëllim ta mbrojë qytetarin nga shkrimet e pavërteta si dhe ta mbrojë gazetarin nga ankesat e pambështetura. Qytetarët mund të ankohen në KMSHK në rastet kur pretendojnë se përmbajtjet në medie të shkruara kanë gjuhë të urrejtjes apo nxitëse. KMSHK bën publike të gjitha vendimet që merr për ankesat në ueb faqe.[25]

Siç evidenton institucioni i Avokatit të Popullit, gjatë vitit 2020, ka pranuar 12 ankesa që lidhen me kapitullin III, në vitin 2021, KMSHK ka trajtuar 10 ankesa, gjatë vitit 2022 gjashtë ankesa.

CEL ka pyetur KMSHK lidhur me numrin e ankesave të pranuar këtë vit. Në vitin 2024, deri më 15 nëntor, KMSHK nuk ka pranuar asnjë ankesë lidhur me gjuhën e urrejtjes kundër njerëzve LGBTIQ+ në medie të shkruara. Ankesa e fundit që KMSHK ka trajtuar është prej nëntorit të vitit 2023. Ankesa ishte dërguar nga CEL Kosova, Center for Social Group Development (CSGD), Youth Initiative for Human Rights (YIHR), Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ), Civil Rights Defenders (CRD). Ankesa kishte të bënte me shkelje të privatësisë së një aktivisti LGBTIQ+, me ç’rast një portal zbulimin e emrit dhe fotografisë të një aktivisti LGBTIQ+. Ankesa ishte miratuar.

Ndërkohë, pos mekanizmave si më lart, kompania Meta, respektivisht rrjeti social Facebook gjuhë të urrejtjes[26] e konsideron sulmin direkt kundër njerëzve — e jo kundër koncepteve a institucioneve — në bazë të karakteristikave të mbrojtura: racës, etnisë, origjinës kombëtare, aftësisë së kufizuar, përkatësisë fetare, kastës, orientimit seksual, seksit, identitetit gjinor dhe sëmundjes serioze. Sulmet i përkufizojnë si të folur çnjerëzues ose të dhunshëm, stereotipe të dëmshme, deklarata të inferioritetit, shprehje të përçmimit, gërdi apo shpërfillje, mallkim dhe thirrje për përjashtim ose segregim.

25. Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës, faqja në internet: parashtrimi i ankesës. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. https://presscouncil-ks.org/?page_id=97

26. Meta, Qendra për Transparencë, politikat, gjuha e urrejtjes. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. <https://transparency.meta.com/en-gb/policies/community-standards/hate-speech/>

Meta kryesisht përdor teknologji të inteligjencës artificiale për ta vërejtur gjuhën e urrejtjes, ndërsa mundëson edhe raportimin nga përdoruesit. Megjithatë, korporatat e mëdha si Meta janë kritikuar për mungesë të vëmendjes së barabartë ndaj përmbajtjeve që publikohen në gjuhë e Bashkimit Evropian, por edhe jashtë tij[27], që nuk janë anglisht — një prej treguesve është numri i vogël i moderatorëve[28].

Për shembull, për gjuhën malteze, në një raport të botuar në vitin 2023, del se është një moderator/e, edhe pse Malta ka rreth 350,000 përdorues[29], ose për sllovenisht, janë 11 moderatorë/e, ndërsa në Slloveni, janë mbi 1 milion përdorues[30] të Facebook.

Anipse shqipja nuk është njëra prej gjuhëve të BE, të dhënat mund të indikojnë që situata është e ngjashme, në mos më keq me përmbajtjet në shqip. Ndërkohë, Akti i Shërbimeve Digjitime të Bashkimit Evropian i detyron kompanitë e mëdha[31] online që, ndër tjera, të publikojnë raporte të transparencës, ku ofrojnë të dhëna rreth numrit të moderatorëve të përmbajtjeve, numrin e vërejtjeve që marrin nga përdoruesit, numrin e përmbajtjeve që janë hequr me vetë nismën e platformës.

Në këtë kontekst, teksta mediet megjithatë janë subjekt të rregullativave të caktuara, seksionet e komenteve paraqesin zonë të përhimtë — ku komentet që përmbajnë gjuhë të urrejtjes mbushin seksionet e komenteve, të papenguara.

II.II KOMENTET: ZONË E PËRHIMTË

Vend të madh në këtë analizë zënë seksionet e komenteve në rrjetin social Facebook. Ato nuk janë në fushëveprimtarinë a kompetencat e KMSHK e as KPM. KMSHK, në përgjigjen për CEL ka thënë që teksta përgjegjësi të trajtimit të KMSHK janë komentet e publikuara nën shkrimet në platformat (web faqet) e mediave të shkruara / online, mediet anëtare të KMSHK kanë rekomanduar një zgjidhje për komentet në rrjetet sociale.

“Vetë mediat anëtare të KMSHK-së kanë rekomanduar që në rastet kur shkrimet e mediave të postuara në rrjetet sociale mund të nxisin gjuhë të urrejtjes ndaj personave ose grupeve të caktuara shoqërore (në këtë rast edhe ndaj personave LGBTQ+), mediat të mbyllin fare mundësinë për komentet e lexuesve, nëse nuk mund t’i moderojnë ato”, shkruhet në përgjigjen e KMSHK.

27. Rishi Iyengar, Facebook has language blind spots around the world that allow hate speech to flourish (Facebook ka pika të dobëta rreth botës që e lejojnë gjuhën e urrejtjes të lulëzojë”, CNN Business, 26 tetor 2021, edition.cnn.com. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. <https://edition.cnn.com/2021/10/26/tech/facebook-papers-language-hate-speech-international/index.html>

28. Global Witness, How Big Tech platforms are neglecting their non-English language users (Si po i shpërfillin platformat e mëdha teknologjike përdoruesit e tyre që nuk përdorin gjuhën angleze), 30 nëntor 2023, globalwitness.org. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. <https://www.globalwitness.org/en/campaigns/digital-threats/how-big-tech-platforms-are-neglecting-their-non-english-language-users/>

29. Nicole Borg, An insight into Malta’s usage of Social Media platforms according to Digital 2023 (Një vështrim përdorimit të përdorimit të platformave të rrjeteve sociale në Maltë sipas Digital 2023), Concept Stadium, 11 prill 2023, conceptstadium.com. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. <https://www.conceptstadium.com/blog/an-insight-into-maltas-usage-of-social-media-platforms-according-to-digital-2023/>

30. Departamenti i hulumtimit i Statista, Numri i përdoruesve të Facebook në Slloveni prej vitit 2019 deri në 2028 (në miliona), 30 janar 2024, statista.com. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. <https://www.statista.com/statistics/568844/forecast-of-facebook-user-numbers-in-the-slovenia/>

31. Komisioni Evropian, politikat, Paketa e Aktit të Shërbimeve Digjitime. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. <https://digital-strategy.ec.europa.eu/en/policies/digital-services-act-package>

Mirëpo, kjo nuk do të thotë që komentet në rrjete sociale janë krejtësisht të paprekshme nga ligji[32]. Në tetor të vitit 2024, Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), ka botuar raportin “Përgjegjësia e mediave ndaj komenteve të paligjshme”, ku shpjegon kornizën ligjore ekzistuese në Kosovë dhe praktikën e GJEDNj[33].

IKD përmend Ligjin nr.02/L-65 Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes dhe Ligjin nr. 04/L-077 për Marrëdhënien e Detyrimeve si ligje relevante për këtë, mirëpo shkruan se asnjë nga ligjet nuk e specifikon saktësisht përgjegjësinë e mediave për komentet e postuara në postime të rrjeteve sociale. Megjithatë, ekziston një precedent i rëndësishëm në GJEDNj — rasti Delfi AS v. Estonia[34], me ç’rast GJEDNj mbajti përgjegjës portalin për komentet në postim, anipse as në Estoni çështja nuk ishte krejt specifikisht e rregulluar.

Në Kosovë, nuk ka një precedent të tillë. Megjithatë, kjo nuk do të thotë që mediet nuk mund të ndërmarrin hapa të ndryshëm për të reduktuar apo shmangur gjuhën e urrejtjes. Një praktikë është ajo që anëtarët e KMSHK kanë propozuar. Një tjetër është ajo që IKD po ndjek — ka zgjedhur të bllokojë mundësinë për komentime në pamundësi për t’i moderuar ato. Një praktikë me vlerë është ajo e revistës online Kosovo 2.0[35]. Kosovo 2.0 qëndron haptazi kundër gjuhës së urrejtjes dhe aktivisht moderon komentet. Pas kësaj, K2.0 është transparente[36] kur fshin një koment, teksa i ka parimet e komentimit të publikuara në ueb faqe.

Edhe Avokati i Popullit në raportin e fundit për gjuhën e urrejtjes, ka rekomanduar që mediet dhe platformat e mediave sociale të angazhohen në rishikimin e kodeve të tyre të sjelljes për të nxitur moderimin e përmbajtjes dhe për ta hequr atë kur është e nevojshme. Pra, mediet mund të realizojnë politika redaktoriale, kode e protokolle të qarta për ta shmangur gjuhën e urrejtjes.

Ato mund të përkushtohen në trajnime dhe nisma tjera për ngritje kapacitetesh. Si shembuj mund të ndjekin platforma të ndryshme vendore (si më lart) dhe ndërkombëtare, të cilat kanë përcaktuar protokolle të tilla dhe ndajnë vazhdimisht[37] metoda e praktika që mund të shfrytëzohen prej mediave tjera.

32. Blerta Agushi, Komentet që lënë vrage, Kosovo 2.0, 27 dhjetor 2023, kosovotwopointzero.com. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. <https://kosovotwopointzero.com/komentet-qe-lene-vrage/>

33. Gzim Shala, Betim Musliu, Përgjegjësia e mediave ndaj komenteve të paligjshme, Instituti i Kosovës për Drejtësi, tetor 2024. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2024/10/Raporti_Pergjegjesia-e-mediave-ndaj-komenteve-te-paligjshme-2.pdf

34. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, shënim informativ rreth rastit 167, Delfi AS v. Estonia, gjykimi më 10 tetor 2013. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. <https://hudoc.echr.coe.int/fre#%7B%22itemid%22:%5B%22002-8960%22%5D%7D>

35. Autorja e kësaj analize është redaktore e lartë në revistën Kosovo 2.0.

36. Kosovo 2.0, Parimet e komentimit, 6 shkurt 2017. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. <https://kosovotwopointzero.com/parimet-e-komentimit-ne-k2-0/>

37. ARTICLE 19, Challenge Hate, pa datë botimi. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. <https://www.article19.org/campaigns/challenge-hate/>


III. PËR ÇKA DHE SI U FOL, KUR U FOL PËR PERSONAT/TË DREJTAT/ÇËSHTJET LGBTIQ+ NË KOSOVË GJATË VITIT 2024?

CEL në këtë analizë përparësi u dha postimeve rreth ngjarjeve që në mënyrë konsistente tërheqin apo mbledhin gjuhë të urrejtjes, homotransfobi, gjuhë fyese, poshtëruese e të papërshtatshme ndaj personave/të drejtave/çështjeve LGBTIQ+.


Kodi Civil tash e disa vjet është një ngjarje e tillë — gjuha rreth tij shpeshherë është e formësuar prej politikanëve/eve e figurave tjera publike, të cilat zunë vend në medie më shumë se vetë personat LGBTIQ+.

Pastaj, u përcollën datat sidomos të rëndësishme për të drejtat LGBTIQ+, si 17 maji e Parada e Krenarisë. 17 maji ishte relativisht e shpërfillur, teksa Parada e Krenarisë solli një vrull postimesh e komentesh. Të drejtat e njerëzve trans, apo postimet që në një formë a tjetrën u lidhën me njerëzit trans, shpërfaqën sërish se njerëzit trans vazhdojnë të shtyhen në skaje të shoqërisë në mënyrë të veçantë — qoftë përmes një raportimi medial që vazhdon të shpërfaqë gabime themelore dhe të shpërfillë praktikën gazetareske të raportimit për njerëzit LGBTIQ+, qoftë përmes seksioneve të komenteve, ku gjuha është veçanërisht përplot urrejtje, qasje poshtëruese dhe përjashtuese.

- Big Brother/të drejtat trans
- Parada e Krenarisë
- Njerëzit në politikë/Richard Grenell
- Ligji për shëndet riprodhues dhe fertilizim të asistuar
- Kodi Civil
- Imane Khelif/të drejtat trans
- Eurovision
- IDAHOBIT
- Marrëveshja me prind, shkolla "Elena Gjika"



Numri i komenteve për çështje



Çështjet për të cilat u shkrua

- Big Brother/të drejtat trans
- Parada e Krenarisë
- Njerëzit në politikë/Richard Grenell
- Ligji për shëndet riprodhues dhe fertilizim të asistuar
- Kodi Civil
- Imane Khelif/të drejtat trans
- Eurovision
- IDAHOBIT
- Marrëveshja me prind, shkolla "Elena Gjika"

III.I KODI CIVIL

Rreth 58 prej 340 postimeve të mbledhura, apo rreth 17% kanë të bëjnë me draft-Kodin Civil. Në të gjitha postimet, përjashto shtatë prej tyre, kishte komente. Mbi 800 komente rreth Kodit Civil u analizuan. Lajmet dhe postimet e realizuara lidhur me Kodin Civil, kryesisht përmbanin deklaratatë të shkurtëra të deputetëve/eve rreth Kodit Civil e deklaratatë të figurave tjera publike, siç janë prijës fetarë e politikanë/e të ndryshëm/me — një shumicë dërrmuese ishin deklaratatë nga njerëz që shprehnin mospajtimet e tyre me përmbajtjen e Kodit Civil, mospajtime që jo rrallë përmbanin dezinformata të qarta, qoftë rreth përmbajtjes së Kodit Civil, qoftë rreth personave LGBTQ+.

Draft-Kodi Civil, një ligj që do të mbulonte e rregullonte aspekte të rëndësishme të jetës publike e private në Kosovë, nuk është lajm i ri, mirëpo vazhdon të mbetet lajm që kurdo që shfaqet në publik, tërheq vëmendje.

Anipse në draftin e Kodit Civil punohet prej vitit 2014, diskutimi për të u shtua sidomos më 16 mars të vitit 2022, kur u nxor për votim në Kuvend. Kodi, në draftin që u nxor për votim, përbëhej prej 1,630 nenesh, mirëpo u fol gati ekskluzivisht vetëm për paragrafin 2 të nenit 1,138. Në këtë paragraf shkruhej: “Bashkësitë e regjistruara civile ndërmjet personave me seks të njëjta janë të lejuara. Kushtet dhe procedura rregullohen me ligj të veçantë”.

Draft-Kodi Civil nuk kaloi në atë seancë dhe që prej atëherë nuk është dërguar më në Kuvend. Disa javë përpara seancës, deputetja që mban një nga tri ulëset e garantuara në Kuvend për boshnjakët dhe kryetarja e komisionit legjislativ përgjegjës për të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore, Duda Balje, bëri një postim^[38] në rrjetin social Facebook, ku tha se e kundërshtonte Kodin Civil, sepse ishte, siç shkroi ajo “kundër fesë të cilës i përkas, principeve në të cilat jetoj e as kundër vlerave familjare me të cilat jam rritur. Prandaj, vota ime do të jetë KUNDËR”. Aty pati komente të shumta (në kohën kur u postua, mbi 1,300^[39]) prej tyre, qartazi komente me gjuhë të urrejtjes kundër personave LGBTQ+.

38.Duda Balje, postim në rrjetin social Facebook: “Të dashur qytetar, Siç jeni në dijeni, nesër në rend të ditës në seancën plenare kemi në shqyrtim dhe votim Kodin Civil. Pikë e rendit të ditës është që ky Kod Civil përmban edhe lejinë e martesave të gjinisë së njëjtë. Unë si deputete nuk mund të dal kundër fesë të cilës i përkas, principeve në të cilat jetoj e as kundër vlerave familjare me të cilat jam rritur. Prandaj, vota ime do të jetë KUNDËR. Kundër, sepse nuk perketë me kulturen, traditën në të cilën kemi jetuar dhe jetojmë”, 23 shkurt 2022. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. <https://www.facebook.com/duda.balje/posts/2136082403221583>

39.Aulonë Kadriu, ‘Nuk e dimë qysh është me qenë të lirë’, Kosovo 2.0, 30 mars 2022, kosovotwopointzero.com. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. <https://kosovotwopointzero.com/nuk-e-dime-qysh-eshte-me-qene-te-lire/>

Pos deputetes Balje, deputetët/et Burim Meta, Gramos Agusholli, Labinotë Demi Murtezi, Mërgim Lushtaku ishin ndër më të zëshmit e aktualizuarit, pasi me një gjuhë homofobike, dezinformuese e edhe që shpërfaqte mosdije e kundërshtuan draftin e ligjit. Për shembull, Demi Murtezi tha se donte ta mbronte moralin publik dhe shëndetin publik. Ajo vazhdoi duke cilësuar çdo lidhje jashtë lidhjeve heteroseksuale si “shthurje dhe degjenerim moral”. Po ashtu, Demi Murtezi tha se “plotësimi i nevojave seksuale në forma të shthurura është në kundërshtim me natyrshmërinë e njeriut [...] është shkaktar i sëmundjeve të rënda, të pashërueshme si HIV/Aids[40].

Ndërkohë, deputeti Agusholli pyeti: “Pse duhet të shkatërrojmë diçka e natyrshme për t’u ndërtuar diçka të re dhe problematike?”[41] duke sugjeruar se Kodi Civil e shkatërron familjen.

Kjo ishte prej shpërfaqjeve më të ashiqarshme të gjuhës së urrejtjes nga përfaqësuesit/et institucionalë/e dhe nuk kaloi pa u vërejtur. Përpos protestës që u mbajt një ditë pas seancës, më 17 mars, përpara Kuvendit me thirrjen “Homofob s’ki vend n’Kuvend”, edhe Departamenti i Psikologjisë në Universitetin e Prishtinës lëshoi[42] deklaratë, në të cilën thuhej se homoseksualiteti nuk është çrregullim mendor, duke inkurajuar ligjbërësit dhe politikanët të veprojnë në harmoni me të drejtat e njeriut.

Po ashtu, reagoi Avokati i Popullit, duke e cilësuar gjuhën e përdorur si gjuhë që përmbante urrejtje, gjuhë të papranueshme dhe gjuhë që nxit polarizim në shoqëri[43].

Teksa për gati dy vjet Kodi Civil ende ka mbetur pjesë e diskutimit, por i pamiratur, gjuha e urrejtjes nuk përfundoi. Në fillim të vitit 2024, në një takim të Komisionit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, të cilit i takon, deputetja Demi Murtezi sërish tha se personat LGBTIQ+ shpërndajnë sëmundje, teksa deputetja Balje tha se qëndron pas kundërshtimit që e ka shfaqur fillimisht e vazhdimisht ndaj Kodit Civil.

40.Kuvendi i Kosovës, Assembly of Kosovo Live Stream - 48 (Transmetimi i seancës parlamentare të 16 marsit 2022), Youtube, tranmestuar live më 16 mars 2022. Për herë të fundit qasur më 22 nëntor. <https://www.youtube.com/watch?v=-cWSD87iFIM&t=28955s>

41.Po aty

42.Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Filozofik, Deklaratë: “Duke iu referuar diskutimeve institucionale dhe publike lidhur me Draft Kodin Civil të Republikës së Kosovës Departamenti i Psikologjisë, Departamenti i Punës Sociale dhe Programi për Studime dhe Hulumtime Gjinore të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës, duke qenë të përkushtuar në zbatimin e standardeve ndërkombëtare për promovimin e shkencës dhe përdorimin e provave shkencore në mbështetje të informimit të drejtë, avancimit të njohurive dhe formimit të vlerave të mira qytetare deklarojmë se: Homoseksualiteti nuk është çrregullim mendor...”, 22 mars 2022. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. https://filozofiku.uni-pr.edu/page.aspx?id=1%2C35%2C1390&fbclid=I%3C%ABAR0o-L8%3C%ABRhM7a_nosnHkakBBf-oG49f582EjMTY6hBnfl_MQBnyOgpsJGDA#

43.Driton Sadiku, Avokati i popullit, kritik ndaj gjuhës së përdorur për kodin civil, ATV, 6 maj 2024, atlive.tv. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. <https://atlive.tv/avokati-i-popullit-kritik-ndaj-gjuhes-se-perdorur-per-kodin-civil/>

Më 1 mars 2024, në Ditën Ndërkombëtare për Zero Diskriminim, YIHR, CEL, CSGD, QKSGJ dhe CRD dorëzuan padi^[44] në Gjykatën Themelore të Prishtinës ndaj Kuvendit të Kosovës dhe deputetes Demi Murtezi për diskriminim dhe cenim të dinjitetit të personave LGBTIQ+. Padia i referohet gjuhës diskriminuese që Demi Murtezi përdori gjatë seancës së Kuvendit të Republikës së Kosovës të marsit 2022.

Për këtë padi, AIP ka nxjerrë një opinion ligjor, në cilësinë e mikut të Gjykatës (Amicus Curiae) për Gjykatën Themelore të Prishtinës, e cila përqendrohet në bazën ligjore dhe mbrojtjen gjyqësore në rastet e diskriminimit, si dhe në analizën e deklaratave të disa deputetëve lidhur me komunitetin LGBTIQ+, të shprehura në seancën plenare të datës 16 mars 2022^[45].

Edhe në internet, gjuha e urrejtjes vazhdoi përgjatë vitit 2024. Prirjet që i karakterizuan postimet dhe komentet ishin si vijon: anipse jo në masë të madhe, kishte lajme rreth Kodit Civil, që i karakterizonte dezinformimi ose keqinformimi, ngjashëm me atë që deputetët/et e bënë në seancën e 16 marsit, se Kodi Civil (gjithnjë referuar formulimit në draftin e shqyrtuar në vitin 2022) njihte apo lejonte martesat midis personave të seksit të njëjtë.

Në fakt, draft-Kodi Civil thoshte se bashkësitë civile, e jo martesat, midis personave të të njëjtit seks lejohen, teksa përcakton se kjo do të hyjë në fuqi vetëm pasi të miratohet një ligj shtesë i veçantë që i përcakton hollësitë. Në fakt, aktivistë/e dhe OJQ që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut, këtë formulim të Kodit Civil e konsideruan kundër kushtetues dhe të pamjaftueshëm. Ata/o i referoheshin nenit 37, paragrafit 1, që thotë: "Në bazë të pëlqimit të lirë, çdokush gëzon të drejtën të martohet dhe të drejtën që të krijojë familje në pajtim me ligjin". Kjo pikëpamje mungoi në mediet e analizuara.

Mbase gjuha e deputetëve dhe figurave tjera publike, të cilët në deklaratat e tyre nuk hezituan të thonin se Kodi Civil njihte martesat midis personave të seksit të njëjtë, kontribuoi që për Kodin Civil të mos diskutohej gati asnjëherë si një ligj, që rregullon plot aspekte tjera të jetës, por që ai të shihej gati ekskluzivisht si ligj që ka të bëjë vetëm me martesat/bashkësitë civile midis personave të seksit të njëjtë.

44.Qendra për Informim, Kritikë dhe Aksion (QIKA), Organizatat për të drejtat e njeriut ngrisin padi kundër Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe deputetes Labinotë Demi Murtezi, QIKA, 1 mars 2024, [qika.org](https://qika.org/organizatat-per-te-drejtat-e-njeriut-ngrisin-padi-kunder-kuvendit-te-republikes-se-kosoves-dhe-deputetes-labinote-demi-murtezi/). Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. <https://qika.org/organizatat-per-te-drejtat-e-njeriut-ngrisin-padi-kunder-kuvendit-te-republikes-se-kosoves-dhe-deputetes-labinote-demi-murtezi/>

45.Institucioni i Avokatit të Popullit në Republikën e Kosovës, Opinioni ligjor i Avokatit të Popullit në cilësinë e mikut të Gjykatës (Amicus Curiae) për Gjykatën Themelore në Prishtinë, R. nr. 175/2024 lidhur me diskriminimin dhe shkeljen e dinjitetit të pjesëtarëve të komunitetit LGBTIQ+, si dhe padinë C.nr 2993/2024 të paraqitur më 1 mars 2024 në Gjykatën Themelore në Prishtinë, 17 tetor 2024. Për herë të fundit qasur më 21 nëntor 2024. <https://oik-rks.org/wp-content/uploads/2024/10/KPD-909-2024-Opinion-i-Avokatit-te-Popullit-Amicus-Curiae-lidhur-me-rastin-175-2024.pdf>

46.Aulonë Kadriu, 'Nuk e dimë qysh është me qenë të lirë', Kosovo 2.0, 30 mars 2022, kosovotwopointzero.com. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. <https://kosovotwopointzero.com/nuk-e-dime-qysh-eshte-me-qene-te-lire/>

47.Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, [gzk-rks.gov.net](https://gzk.rks-gov.net), 9 prill 2008. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

Deputetët/et, bashkë me figura tjera publike, po ashtu kontribuuan në një keqkuptim e keqkonceptim të përgjithshëm ndaj asaj se çka lejon e çka s'lejon Kodi Civil, apo ndaj asaj se çka është e çka nuk është ky projekt-ligj.

Kësaj situate mund t'i kenë kontribuar edhe mënyra se si u raportua për Kodin Civil — duke bashkëngjitur një fotografi të ngjyrave të ylberit, duke mos sqaruar se çka njëmend përfshinte Kodi Civil, duke mos folur për rëndësinë e përgjithshme të Kodit Civil, duke cituar kryesisht figura që kanë kundërshtuar Kodin Civil vetëm e vetëm për shkak të paragrafit 2 të nenit 1,138, duke cituar kryesisht figura fetare që flasin ekskluzivisht për dëmet që ata konsiderojnë se Kodi Civil i sjell, duke mos folur pothuajse asnjëherë për rëndësinë e njohjes ligjore të të drejtave LGBTQ+ e duke mos sjellur pikëpamje, përvoja e rrëfime të vetë njerëzve LGBTQ+ rreth çështjes.

Kjo mjegulli e krijuar mund të jetë e dëmshme në tri rrafshë: së pari, përçon mesazh të pasaktë rreth asaj që Kodi është e lejon, së dyti, bën njerëzit LGBTQ+ të duken disi si fajtorë për ngërçin kur është fjala për kalimin e këtij Kodi, së treti, largon vëmendjen prej përmbajtjes tjetër të Kodit, që është po aq e rëndësishme për jetën e qytetarëve/eve të Kosovës e që meriton po aq vëmendje publike, ashtu që të mos përvidhet diçka që do të ndikojë më vonë jetët e qytetarëve të Kosovës.

Pra, lajmet rreth Kodit Civil, kryesisht ishin shkëputje të ndonjë deklaratë të ndonjë deputeti/eje, prijësi/je fetar/e apo figure publike politike rreth tij. Kishte lajme që duke cituar deklarata të llojit: “personat LGBTQ+ bartin sëmundje”; apo “personat LGBTQ+ shkatërrojnë familjet” pa ofruar më shumë informacion e shpjegim, automatikisht krijonin një ambient të plleshëm për gjuhë urrejtjeje, të papërshtatshme e përjashtuese ndaj njerëzve LGBTQ+.

Po ashtu, kishte lajme/postime që në përshkrimet e tyre (captions) u referoheshin personave LGBTQ+ me termin “dylber”, i cili, anipse shpesh është përvetësuar nga aktivistët/et LGBTQ+, si përpjekje për t'i rimarrë fjalët e për t'i kthyer në shërbim të tyre, kur përdoret në kontekste të këtilla e të shkëputura — jo përbrenda nismave aktiviste e jo nga vetë njerëzit LGBTQ+ — rrezikon të normalizojë dhe inkurajojë përdorimin e termave historikisht të papërshtatshëm e problematikë ndaj njerëzve LGBTQ+.

Në raste krejt të rralla (një ose dy raste), aktivistë/e LGBTQ+ u ftuan për të folur në intervista a diskutime rreth Kodit Civil, apo u cituan në lajmet për Kodin Civil.

Sa u përket komenteve, pothuajse të gjitha komentet në të gjitha postimet rreth Kodit Civil ishin komente që paraqisnin kundërshti ndaj Kodit Civil. Komentuesit/et kryesisht promovuan narrativa se njerëzit LGBTQ+ shkatërrojnë e shuajnë familjen, se ata/o janë degjenerim, turp, antivlerë dhe se shpërndajnë sëmundje.

Vërehej qartë se komentuesit, Kodin Civil nuk e diskutonin përtej paragrafit 2, nenit 1,138 dhe se përgjithësisht e shihin Kodin Civil si sinonim të martesave midis personave të seksit të njëjtë.

Po ashtu, njerëzit shfrytëzuan lajmet rreth Kodit Civil ose për të thënë se nuk do ta votojnë më partinë në pushtet, ose për ta arsyetur partinë në pushtet, duke thënë se ky është obligim i imponuar nga Bashkimi Evropian. Kjo dhe sidomos fakti se Bashkimi Evropian ishte prej mbështetësve më të mëdhenj të Kodit Civil u instrumentalizuan për ta çuar përpara këtë narrativë. Asnjëra nga portalet e përcjellura nuk aplikonte heqjen e komenteve të urrejtjes — vetë prania e këtyre komenteve e fakteve këtë.

III.II 17 MAJI, MUNDËSI E HUMBUR PËR T'I VËNË NË PAH PËRVOJAT LGBTIQ+

Rreth shtatë (7) përmbajtje/postime apo rreth 2% e të gjitha përmbajtjeve, që u analizuan rreth çështjeve që lidhen me të drejtat a njerëzit LGBTIQ+ u postuan në Ditën Ndërkombëtare Kundër Homofobisë, Bifobisë dhe Transfobisë (IDAHOBIT), më 17 maj 2024.

Tri prej tyre lajmëronin që Qeveria e Kosovës ka ndriçuar ndërtesën me ngjyrat e ylberit me lajme të shkurtëra një-dy paragrafëshe. Katër prej tyre botuan të plotë një deklaratë të një grupi ambasdash për rreth rëndësisë së ditës dhe mbrojtjes së të drejtave LGBTIQ+.

CEL nuk hasi në ndonjë artikull — prej dymbëdhjetë portaleve — që sillte zëra autentikë LGBTIQ+ tek flisnin vetë, qoftë për aktivizmin e bujshëm në kuadër të IDAHOBIT[48], qoftë për përvojat e njerëzve LGBTIQ+ në Kosovë. Nuk kishte ndonjë përmbajtje që fliste për sfidat sistematike e sistematike, që vazhdojnë t'u pamundësojnë njerëzve LGBTIQ+ qasjen e plotë e të papenguar në të drejtat e tyre si qytetarë të Kosovës.

Sa u përket komenteve, 92 prej të gjitha komenteve të analizuarra ishin në postimet që lidheshin me IDAHOBIT. Në lajmet/postimet rreth ndriçimit të ndërtesës së qeverisë, pothuajse çdo koment, në mënyrë eksplicite shprehte zhgënjimin me vendim të qeverisë, teksa një shumicë dërrmuese po ashtu shpërfaqën gjuhë urrejtjeje.

48.Dafina Halili, Ardhja e IDAHOBIT në Kosovë, Kosovo 2.0, 17 maj 2020, kosovotwopointzero.com. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. <https://kosovotwopointzero.com/ardhja-e-idahobit-ne-kosove/>

Në postimet/lajmet rreth deklaratës së ambasadave, po ashtu pothuajse secili koment paraqiste kundërshtim, ose urrejtje, ose poshtërim, fyerje ndaj njerëzve LGBTQ+, teksa narrativa mbizotëruese ishte se “personat LGBTQ+ i ka sjellur Evropa” dhe se “Evropa po na detyron/imponon të pranojmë personat LGBTQ”. Përbrenda kësaj narrative, kishte komente që ftonin për përsëritje të nazizmit — koment që nëse jo prej portalit, do të duhej të binte në radarin e kufizuar të rrjetit social Facebook.

Narrativa se njerëzit LGBTQ+ janë koncept i ri, i importuar nga Perëndimi janë të vazhdueshme e në thelb, përpjekje për të fshirë historinë e vjetër, të pasur dhe kontributin e njerëzve LGBTQ+[49]. Është po ashtu përpjekje për të refuzuar praninë e tyre përgjatë të gjitha fazave të ekzistencës e zhvillimit të njerëzimit.

III.III PARADA E KRENARISË, LAJME SHUMË, NË NJË DITË TË VETME

Prej 340 postimeve/lajmeve të analizuara, 68 ishin rreth Paradës së Krenarisë — numri më i madh i postimeve rreth një ngjarjeje/çështjeje të caktuar. Kjo i bie rreth 20% e të gjitha përmbajtjeve të analizuara janë postuar qoftë në fillim të javës së krenarisë, më 3 qershor, qoftë më 8 qershor kur u mbajt Parada e tetë e Krenarisë. Shumica dërrmuese ishte përmbajtje e postuar më 8 qershor.

Këtë vit, Java e Krenarisë pati për tog-fjalësh “Kemi qenë dhe do t’jemi”. Java e Krenarisë ishte plot ngjarje — mbrëmje muzikore, biseda, konferenca e shfaqje teatrale[50]. Këtë tog-fjalësh, sipas ueb faqes së Krenarisë e përdorën për të përshkruar ndjenjën e krenarisë, për atë që janë e për atë ku do të arrijnë, ku do të lartohen. “Ekzistenca jonë është në paradën tonë të përditshme, në defileun tonë në një vend ku ngjyrat shpesh pengojnë. Duke e respektuar të kaluarën tonë, ne duam të shohim kah e ardhmja. Heshtja ka qenë mekanizmi ynë për shumë gjatë, por jo tash e tutje. Në mes të sfidave e vështirësive, shpirtrat tanë kanë mbetur të fuqizuar”, vazhdon deklaratata.

Në kuadër të Javës së Krenarisë, u realizua aksioni rrugor “Sheshi i Krenarisë” ku përpara Hotelit Grand në Prishtinë, zebrat rrugore u ngjyrosën me ngjyrat e ylberit dhe u vendos shenjë rrugore që shkruante “Sheshi i Krenarisë”. Kjo, sipas organizuesve të Pride ishte një “akt i festimit kolektiv dhe rezistencës nxori në pah përkushtimin tonë për të zënë hapësirat publike dhe theksoi diversitetin e qyteteve dhe vendit tonë”.

49.UNWOMEN, shpjegues: LGBTQ+ communities and the anti-rights pushback: 5 things to know (Komunitetet LGBTQ+ dhe përpjekjet kundër të të drejtave: 5 gjëra për t'i ditur), 28 maj 2024, unwomen.org. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. <https://www.unwomen.org/en/news-stories/explainer/2024/05/lgbtiq-communities-and-the-anti-rights-pushback-5-things-to-know>

50.Prishtina Pride, faqja e internetit. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. <https://prishtinapride.org/>.

Megjithatë, dy ditë pas, aksioni rrugor u shkatërrua[51] e u mbulua me fyrje e gjuhë urrejtjeje kundër personave/të drejtave/çështjeve LGBTIQ+.

Avokati i Popullit e quajti këtë veprim të papranueshëm, duke thënë se “Veprime të tilla janë të papranueshme në një shoqëri ku vlerat kushtetuese bazohen në parimet e lirisë, të paqes, të demokracisë, të barazisë, të respektimit të të drejtave të njeriut, të sundimit të ligjit dhe të mosdiskriminimit”[52].

Lajmet rreth Paradës së Krenarisë kryesisht nuk shkonin më larg sesa njoftime rreth fillimit të Paradës, figurave publike që iu bashkuan paradës, videove nga ecja dhe deklarata nga politikanë/e rreth Paradës apo arsyes përse ata/o kanë dalë në Paradë.

Një lajm që përmendte Paradën, por që ishte i postuar në tetor, paraqiste deputetin, Eman Rrahmani në një emision televiziv teksa thoshte se shumica e organizatave që i prijnë Paradës e kanë bazën në Serbi. Rrahmani aktivizmin për të drejtat LGBTIQ+ po ashtu e quajti më shumë agjendë. Kjo deklaratë është, në rastin më të mirë, lehtësisht e interpretueshme si dashakeqe e në rastin më të keq, dezinformuese dhe përpjekje e qartë për të diskredituar lëvizjen LGBTIQ+ dhe për të insinuar se ajo ka njëfarë lidhjeje me ndonjë agjendë të qeverisë së Serbisë.

Ngjashëm me gjuhën e përdorur në shesh ishte edhe gjuha e përdorur në internet. 5,782 apo 21% prej të gjitha komenteve të analizuara në postimet e analizuara ishin në postimet rreth Paradës së Krenarisë. Shumica dërmuese, në mos të gjitha komentet, ishin me përmbajtje ose të urrejtjes, ose poshtëruese ndaj personave LGBTIQ+.

Nëse marrim si ilustrim një postim rreth paradës me mbi 700 komente dhe i shohim prirjet kryesore komentuese, atëherë: një pjesë e madhe ishin lutje të drejtpërdrejta për shfarosje të njerëzve LGBTIQ+; një pjesë e madhe e komenteve ishin ftesa eksplicite për t’i vrarë, shkatërruar, shfarosur njerëzit LGBTIQ+; një pjesë tjetër e komenteve shprehnin zhgënjimin e tyre që figura famëkeqe që kanë ushtruar gjenocid, spastrim etnik e shtypje mbi popullësi të tëra, disa të njohur sidomos për shtypjen e njerëzve LGBTIQ+, si nazisti Adolf Hitler apo diktatori Enver Hoxha e deri te njeriu i njohur si “Kasapi i Ballkanit”, Slobodan Milošević nuk janë gjallë, për t’i shfarosur njerëzit LGBTIQ+; një pjesë e quanin Paradën të turpshme, njerëzit LGBTIQ+ si shkatërrues të familjes, shpërndarës të sëmundjeve; derisa një pjesë përdornin shprehje të njohura si poshtëruese e urrejtje ndaj njerëzve LGBTIQ+.

51.Dylberizm, Vandalizohet “Sheshi i Krenarisë” me mbishkrime homofobe, 7 qershor 2024, dylberizm.com. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. https://www.dylberizm.com/2024/06/07/p_w_5/

52.Dylberizm, Avokati i Popullit: Vandalizimi i zebrave të krenarisë me urrejtje, i papranueshëm, 12 qershor 2024, dylberizm.com. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. https://www.dylberizm.com/2024/06/12/a_popullit/

Në të gjitha portalet, postimet rreth Paradës, por përgjithësisht postimet që kishin të bëjnë me LGBTIQ+ komentoheshin më shumë sesa postimet tjera të ditës dhe po ashtu, komentet e urrejtjes, poshtëruese e ofenduese u lejuan. Edhe këtu, thirrjet e qarta për vrasje, bombardim, masakrim e çka jo të njerëzve LGBTIQ+ si duket nuk u vërejtën nga kompania Meta e as nuk u panë si përmbajtje që duhet fshirë nga portalet.

Ajo që shpërfaqet është po ashtu përqendrimi i medieve në një ditë të vetme për të raportuar për diçka që lidhet me të drejtat LGBTIQ+ — me shumicë, por jo domosdo me kontekst që do të shpjegonte rrethanat në të cilat po organizohej Parada, politikat e ndryshme që ndikojnë jetët e qytetarëve LGBTIQ+, boshllëqet institucionale që pengojnë njerëzit LGBTIQ+ nga realizimi i plotë i të drejtave të njeriut.

Këto lajme, aq sa do të kishin mundur të jenë pjesë e portaleve me lexueshmëri të madhe gjatë ditës së Paradës së Krenarisë, do të mund të kishin qenë pjesë e tyre në mënyrë konsistente.

III.IV NJERËZIT TRANS, VEÇANËRISHT TË PËRJASHTUAR NË INTERNET

III.IV. I EDONA JAMES DHE BIG BROTHER VIP KOSOVA

Prej postimeve të analizuara, rreth 45 apo 13.3% ishin rreth reality show, Big Brother VIP Kosova (BBVK), e prej tyre 35 rreth Edona James (ka pasur shumë më shumë postime rreth Edona James, por CEL ka zgjedhur disa prej tyre, që janë më ilustrues rreth mënyrës së raportimit rreth Edona James, si dhe mënyrës së komentimit). Kurse prej të gjitha komenteve, 6,570 ishin në postimet rreth BBVK, e shumica dërrmuese e tyre specifikisht për Edona James. Anipse për Edona James u raportua edhe pas përfundimit të BBVK, meqë rishfaqja e Edona James lidhet ngushtë me BBVK, artikujt rreth saj janë futur në kategorinë Big Brother.

Edona James është transgrua që u bë e njohur në Kosovë në vitin 2014 kur u paraqit në një emision vendor. Prej atëherë, James u komentua e stërkomentua, me emrin e saj që u shndërrua në njëfarë sinonimi të të qenit trans e që shpesh përdorej me konotacion ofendues e përçmues.

Anipse nuk u paraqit shpesh në medie pas asaj interviste, kryesisht për shkak të vërshimit të gjuhës së urrejtjes e kërcënimeve ndaj saj, James u kthye në televizion gati 10 vjet pas intervistës — këtë herë për t'iu bashkuar edicionit të dytë të BBVK, të mbajtur kah fundi i vitit 2023 dhe fillimi i vitit 2024.

Derisa James ishte personazh i dashur për plot — James ishte një prej katër finalistëve/ëve të programit, si dhe sipas Freedom House[53], kjo mbështetje u konsiderua si ndërrim pozitiv në perceptimin publik rreth njerëzve trans, ajo po ashtu shpërfaqti se sa shumë transfobi ka në internet e përtej.

Fakti që për James u raportua kaq shumë, por një raportim kaq i madh e konsistent mungon kur është fjala përgjithësisht njerëzit trans që jetojnë në Kosovë, e që janë një prej grupeve më të shtypura shoqërore, si dhe marrë për bazë numri i komenteve të shumta që postimet rreth James marrin, sugjeron që emri i James mund të jetë shfrytëzuar për të senzacionalizuar e për të tërhequr komente/pëlqime e angazhime në rrjetet sociale të portaleve.

Të gjitha portalet — me përjashtim të tri prej tyre — postuan përmbajtje që jo domosdo ishin relevante apo përbënin ndonjë interes publik rreth Edona James. Po ashtu, disa portale nuk hezituan të shkruanin “Transgjjinorja Edona James” apo “Transgjjinorja” anipse identiteti gjinor i James ishte krejt jo-relevant për lajmin. Po ashtu, përkundër praktikave të rekomanduara kur është fjala për raportim për çështjet LGBTQ+[54], stërtheksimi i fjalës “transgjjinore”, e edhe përdorimi i termit si emër, shpërfaq tendencën për të nxitur komente.

Komente pati shumë e shumica ishin komente me gjuhë të urrejtjes, komente poshtëruese, ofenduese, transfobike. Për ilustrim, do të shfrytëzohen tri postime rreth Edona James apo Big Brother me numrin më të madh të komenteve. Këto tri postime kanë të bëjnë me: 1) faktin që Edona James kishte arritur një numër klikimesh në një rrjet social dhe mundësia që ajo të fitonte BBVK— numri i komenteve ishte mbi 500; 2) një citat i nënës së Edona James — numri i komenteve ishte mbi 800 dhe 3) një lajm ku Edona James flet për kërcënimet që kishte marrë — numri i komenteve ishte afër 900.

Në postimin e parë, shumica dërrmuese paraqisnin kundërshtimin e tyre ndaj një fitoreje të mundshme të James, derisa pati shumë komente që e quanin James degjenerim, turp, njeri kundër vullnetit të zotit dhe emra tjerë përçmues.

53. Freedom House, Kosovo Country Report. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. https://freedomhouse.org/country/kosovo/nations-transit/2024?fbclid=I%3C%ABZXh0bgNhZ%3C%ABOCMTAAAR3s3dJYIMbBuqfQIdcRvXvKs3Ja%3C%ABRn%3C%ABLqnrV78ffLV3FP%3C%ABZOMZQ6Qvejhl_aem_A%3C%ABoTX9SegThfQlxiNUfHkxAcT4ijbmi6uMYT_ZBYPG7%3C%AB2pAq14lEmoCRxyVgl6_5%3C%ABUnJvgcEG3LiApv3mU70wKoV

54. Adora Limani, Mbulimi sensacionalist medial e çnjerrëzon Edona James (blog), Kosovo 2.0, 4 qershor 2024. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. <https://kosovotwopointzero.com/mbulimi-sensacionalist-medial-e-cnjerrëzon-edona-james/>

Ajo që ishte po ashtu e pranishme ishte këmbëngulja e njerëzve që ta thërrisnin James me emrin që ia kishin lënë në lindje, duke iu drejtuar me përemra “ai” e jo “ajo”, duke i thënë mashkull, apo duke përdorur fjalë tjera përçmuese që zakonisht përdoren për njerëzit LGBTQ+.

Në postimin e dytë, ku flet nëna e James dhe tregon mbështetje për të bijën, anipse ka tek-tuk komente që shfaqin respekt ndaj saj dhe solidaritet, ka një mobilizim të madh edhe kundër komentuesve që shfaqin respekt e edhe kundër nënës së James dhe vetë James. Komentet, kryesisht fajësojnë nënën e James për “rritje të keqe”; thonë që nëna e James nuk duhet të ndihet krenare me, çfarë komentuesit e quajnë degjenerim, bëjnë thirrje për vrasje të James duke e quajtur si njeri që ka dalur kundër vullnetit të zotit. Edhe në këtë postim, komentuesit i referohen James me emrin që ia kishin lënë në lindje, duke shpërfillur emrin e saj të zgjedhur, si dhe këmbëngulën t’i drejtohen me përemra mashkullorë.

Në postimin e tretë, derisa e njëjta retorikë si më lart vazhdoi, u shtuan komentet që arsyetonin kërcënuesit, po ashtu duke thënë se me dikë si James nuk ia vlente të marred askush apo “t’i përlyente duart” sepse sipas komentuesve, James e kishte mallkuar mjaftueshëm zoti. Përgjithësisht, edhe në lajmet tjera rreth këtij edicioni të BBVK u shpërfaq transfobi dhe kundërshti me pjesëmarrjen e James. Po ashtu, garues/e të ndryshëm/me u fyen me terma ofendues, që kryesisht përdoren për të ofenduar njerëzit LGBTQ+.

Një shembull i freskët e po ashtu i rëndë i keqraportimit kur është fjala për njerëzit trans është mënyra se si u raportua vdekja e aktivistes dhe performueses drag, Anna Kolukaj[55] në vitin 2022. Anna i dha fund jetës në korrik të vitit 2022 dhe mediet nxitimthi raportuan për rastin, shpeshherë duke iu referuar asaj me emrin që i kishin dhënë në lindje, e jo emrin e saj të zgjedhur.

Mediet përdorën tituj që po ashtu e konsideronin Annën si djalë, apo përdornin përemra të gabuar për të[56]. Po ashtu, mediet nxituan të jepnin hollësi rreth Annës apo mënyrës së vdekjes së saj, njëherit duke dështuar t’i ndjekin udhëzuesit se si duhet raportuar rreth vetëvrasjes.

Pos kësaj, shpejt mediet raportuan se Anna ishte pjesë e komunitetit LGBTQ+, gjë që shtoi tutje gjuhën e urrejtjes nëpër seksionet e komenteve. Portalet e analizuara nuk mësuan prej këtij rasti dhe sërish dështuan t’u siguronin njerëzve trans një hapësirë të sigurt e të dinjitetshme mediale.

55.Dafina Halili, “Na jemi gra dhe nuk dëshirojmë me u plakë si burra”, Kosovo 2.0, 8 gusht 2022. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. <https://kosovotwopointzero.com/na-jemi-gra-dhe-nuk-deshirojme-me-u-plake-si-burra/>

56.Dardan Hoti, Mediet dhe njerëzit LGBTQ+ (blog), Kosovo 2.0, 2 qershor 2023. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. <https://kosovotwopointzero.com/mediet-dhe-njerezit-lgbtq/>

III.IV.II NJË OLIMPIANE QË SHPËRFAQI RAPORTIMIN E PANDJESHËM

Rreth dhjetë (10) artikuj të mbledhur, me rreth 760 komente, janë për Imane Khelif, boksiere profesioniste nga Algjeria, si dhe tashmë fituese e medaljes së artë olimpike në vitin 2024. Khelif nuk u bë e njohur thjesht si një sportiste e suksesshme, që ka arritur të prekë ëndrrën e plot sportistëve në botë.

Kundërshtarja e parë e Khelif ishte një boksiere nga Italia, e cila nuk ia doli të vazhdonte lojën pas 46, sekondave duke dhënë një deklaratë ku tha se “kurrë s’kishte përjetuar një goditje të atillë”.

Kjo deklaratë e nisi një diskutim të tërë rreth seksit të Khelif dhe rreth asaj nëse ajo ishte lindur mashkull dhe kishte bërë tranzicion. Diskutimi u ndihmua sidomos prej figurave politike si kryeministrja e Italisë, Georgia Meloni[57], ish-presidenti i SHBA, Donald Trump[58].

Përkundër që institucionet përkatëse në Lojërat Olimpike konfirmuan sërish se Khelif ishte aty ku përkiste, interneti eksplodoi me një fushatë përjashtuese, të urrejtjes e dezinformuese[59] kundër Khelif. Nuk kishte më rëndësi as demantimi Khelif ndaj këtyre lajmeve e as dematimet e babait të saj.

Portalet e analizuar në Kosovë iu bashkuan prirjes botërore dhe publikuan përmbajtje dezinformuese e nxitëse. Nga dhjetë artikuj, disa prej të cilëve keqcitonin boksiere italiane, e quajtën Khelif “sportiste transgjimore”, “boksiere transgjimore”. Edhe nëse kishte artikuj që thjesht raportonin për lojën e Khelif, prapëseprapë gjuha transfobike vërshoi në komente. Shumica e komenteve, ngjashëm me rastin e James e quanin degjenerim, turp e kundër vullnetit të zotit. Në shumë komente ajo u krahasua edhe me James — normalisht në korniza ofenduese, të urrejtjes dhe poshtëruese.

57.Csongor Körömi, 46 seconds of women’s boxing fanned the culture war flames (46 sekondat e boksit të grave që ndezën flakët e luftës kulturore), Politico, 1 gusht 2024, politico.eu. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. <https://www.politico.eu/article/culture-war-women-boxing-angela-carini-olympics-imane-khalif-testosterone-giorgia-meloni/>

58.Associated Press, Trump again decries two gold medalist Olympic athletes, falsely labeling the female boxers as men (Trump ankohet sërish për dy medaliste të arta olimpike, duke i etiketuar rrejshëm femrat si burra), 18 gusht 2024, apnews.com. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. <https://apnews.com/article/donald-trump-imane-khelif-li-yuting-57afb62e90968c06277118135e47e759>

59.Rachel Baig, Boxer Imane Khelif targeted by hate speech, disinformation (Boksiera Imane Khalif e shënjestruar nga gjuha e urrejtjes, dezinformatat), Deutsche Welle, 6 gusht 2024, dw.com. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. <https://www.dw.com/en/paris-olympics-boxer-imane-khelif-battles-hate-speech/a-69863650>

IV.ÇËSHTJET TJERA KU U MANIFESTUA HOMOTRANSFOBIA NË INTERNET.

CEL analizoi edhe një sërë përmbajtjesh/postimesh e komentesh tjera që tërhoqën komente me gjuhë të urrejtjes, fyese e homotransfobike. Më poshtë shkurtimisht se cilat ishin ato përmbajtje dhe çka u komentua kryesisht.

IIV.I HOMOFOBI KUNDËR NJERËZVE NË POLITIKË

Rreth 27 postime e 2,400 komente të analizuara kishin të bënin me ish të dërguarin presidencial të Trump për negociatat e paqes midis Serbisë dhe Kosovës, Richard Grenell. Grenell u bë i njohur për angazhimin e tij në Kosovë — angazhim jo rrallë i kritikuar, derisa vetë kryeministri i Kosovës, Albin Kurti e akuzoi Grenell se kishte gisht në rrëzimin e qeverisë së tij të parë[60].

Grenell, i cili ishte po ashtu personi i parë gay që mbajti një post të nivelit të kabinetit në SHBA[61].

Derisa 27 postimet rreth Grenell kishin të bënin kryesisht me ndonjë deklaratë të tij apo ndonjë veprim përbrenda rolit të tij politik, komentet, pothuajse në secilin postim e shfrytëzuan seksualitetin e tij për ta ofenduar atë. Pa diskutuar mënyrën se si Grenell ushtroi detyrën e tij, këto komente homofobike shpërfaqin një gatishmëri të rritur të përdoruesve që të përpiqen ta diskreditojnë çdo politikan apo nëpunës me të cilin nuk pajtohen, duke instrumentalizuar seksualitetin.

Pos Grenell, kishte edhe politikanë/e tjerë/a — në rreth 10 postime — që, qoftë për shkak të karakteristikave të veta trupore, qoftë për shkak të mënyrës së të folurit apo sjelljes, qoftë për shkak se kishin ndarë orientimin seksual të tyre, apo për shkak se njerëzit nuk pajtoheshin me veprimet e tyre politike u ofenduan me gjuhë homotransfobike. Pra, pos një gjuhe të urrejtjes, ofenduese e poshtëruese që shpërfaqej ndaj figurave të ndryshme për shkak të veprimeve të tyre politike — disa prej tyre ofendoheshin e urreheshin edhe me gjuhë homotransfobike.

60.Nicholas Kulawiak, Çka nënkuptojnë zgjedhjet në SHBA për Kosovën, Kosovo 2.0, 11 shtator 2024, kosovotwopointzero.com. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. <https://kosovotwopointzero.com/cka-nenkuptoje-zgjedhjet-ne-shba-per-kosoven/>

61.Phil Thomas, Trump appoints first openly gay cabinet member to head US intelligence (Trump emëron anëtarin e parë haptazi gay që ta udhëheq inteligjencës e SHBA), Independent, independent.co.uk. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. <https://www.independent.co.uk/news/world/americas/us-politics/richard-grenell-trump-gay-acting-director-national-intelligence-cabinet-a9345496.html>

IV.II LIGJE TË INSTRUMENTALIZUARA PËR HOMOTRANSFOBI

Në fillim të vitit 2024 bëri bujë kundërshtia e madhe e disa deputetëve/eve të Kuvendit ndaj Projekt-ligji për Shëndetin Riprodhues dhe Fertilizim të Asistuar^[62]. Çka u kundërshtua me të madhe ishte sidomos neni 15 i këtij projektligji, që i njeh edhe gratë beqare mbi moshën 18-vjeçare si shfrytëzuese të së drejtës për fertilizim të asistuar.

Si krah për krah me kundërshtimin ndaj këtij Ligji, u shfaq dalëngadalë edhe ajo që tashmë njihet si “Lista për Familjen”, një listë e përbërë prej tashmë ish anëtarëve/eve të LVV, Eman Rrahmani e Visar Korenica, të cilët ishin ndër më të zëshmit kundër projekt-Kodit Civil e projekt-ligjit për shëndet riprodhues e fertilizim të asistuar. Ata, në koalicion me partinë Aleanca Kosova e Re (AKR) dhe Partinë e Drejtësisë, udhëhequr prej Ferid Aganit, u regjistruan në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) dhe do të garojnë në zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë, që do të mbahen më 9 shkurt 2025. Ferid Agani, dikur ministër i shëndetësisë, u riaktualizua sidomos pas deklaratave të tij, shpesh kundërthënëse^[63], lidhur me ligjin për shëndet riprodhues dhe fertilizim të asistuar.

Nga 16 artikujt që u analizuan e që kishin të bënin ose me Ligjin për shëndetin riprodhues, ose me Listën për Familjen, u ndoq një narrative tejthjeshtuese duke e lidhur disi Ligjin për shëndet riprodhues me të drejtat LGBTQ+, e edhe me Kodin Civil. Këto ligje paktoheshin si pjesë e një nisme të përbashkët për ta “shkatërruar familjen”.

Përbrenda kësaj narrative edhe u komentua. Rreth 900 e komenteve të analizuara kishin të bënin me këtë çështje. Derisa një tabor komentonin kryesisht me fyerje për Rrahmanin e Korenicën për shkak të dorëheqjes së tyre nga LVV, tabori tjetër komentonin se do ta votonin këtë Listë për shkak se ajo po mbron familjen dhe po e mbron vendin nga ai që komentuesit shpesh e quajtën degjenerim e turp.

IV.III TË REFUZUARIT/AT E EUROVISION

Nëntë (9) artikuj të mbledhur, me gjithsej 349 komente kishin të bënin me festivalin Eurovision, që u mbajt në maj të vitit 2024. Lajmet kryesisht lidheshin me fitoren e Nemo nga Zvicra. Nemo prezantohet me përemrat ata-o (they) dhe janë jo-binarë.

62.Zyra e Kryeministrit, Republika e Kosovës, Projektligji për shëndet riprodhues dhe fertilizim të asistuar, konsultimet.rks-gov.net. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=41528>

63.Shqipe Gjocaj, Kush po tutet prej grave të pamartuara?, Kosovo 2.0, 3 qershor 2024, kosovotwopointzero.com Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. <https://kosovotwopointzero.com/kush-po-tutet-prej-nenave-te-pamartuara/>

Nemo, me këngën "The Code"[64] paraqitën rrugëtimin e tyre në gjetjen e vetes, duke u përpjekur të jenë frymëzues/e edhe për të tjerët/at që kalojnë nëpër kërkime të ngjashme. Lajme tjera rreth Eurovision, ndonëse më pak, kishin të benin me performancën e Conchita Wurst, që është emri i personës drag të këngëtarit austriak, Thomas Neuwirth.

Wurst, me këngën e saj "Rise like a phoenix" në vitin 2014 fitoi në edicionin e Eurovision, derisa në vitin 2024, performoi prapë si një prej fitueseve. Wurst, kur përdor emrin e saj të drag Conchita Wurst, prezantohet me përemra "ajo, i/e saj, asaj", përndryshe identifikohet si burrë gay, me përemra "ai, ajo".

Që të dy llojet e lajmeve a postimeve ishin po aq sipërfaqësore dhe nuk thelloheshin më shumë në karrierat e performuesve/eve. Njëkohësisht, disa prej tyre po ashtu vendosnin theks në faktin se këto performanca mbështesnin "hapur", siç shkruanin disa portale, personat LGBTQ+, por portalet dështonin të shkonin përtej kësaj — të flisnin për motivet, qëndrimet, aktivizmin, përjetimet e tyre apo të tregonin interesim se përse këta njerëz janë të përkushtuar ta shfrytëzojnë artin e tyre për kauzën LGBTQ+. Po ashtu, medie të ndryshme, Nemos iu drejtuan me përemra të gabuar, duke e prezantuar me përemra mashkullorë.

Këto postime mblodhën kryesisht urrejtje, komente përçmuese, fyese e homotransfobike ndaj Nemo dhe Wurst. Përsëri, përpos termeve përçmues e ofendues, u provua të paktohet një narrativë se "Evropa po shkon drejt degjenerimit" apo se "Duhet të jesh transgjitor apo gay për të fituar në Evropë".

Derisa arti shfrytëzohet shpesh për të çuar përpara kauza të rëndësishme — dhe ia del — të drejtat LGBTQ+, njerëzit në ballë të këtyre kauzave vazhdojnë të përballen me rrezikun e përjashtimit, shtypjes e urrejtjes.

Edhe kur personat LGBTQ+ jo domosdo përpiqen aktivisht të çojnë përpara një kauzë të caktuar, ata/o prapëseprapë janë më të ekspozuar ndaj urrejtjes dhe përpjekjes për diskreditim dhe mosnjohje të suksesit për shkak të orientimit të tyre seksual a identitetit gjinor.

IV.IV NJË MARRËVESHJE QË ÇOI PLUHUR

Një ngjarje tjetër që po ashtu tërhoqi vëmendje e që është relevante kur flitet për gjuhën e përdorur ndaj njerëzve LGBTQ+ në internet ishte kur shkolla fillore e mesme e ulët në Prishtinë "Elena Gjika", në një dokument, marrëveshje midis prindërve dhe shkollës, në hapësirat ku duhej shkruar emrat e prindërve dhe nënshkrimet e tyre, përdori "Prindi 1" dhe "Prindi 2".

64. Pedro Santos, Nemo from Switzerland: "The Code has unlocked me musically" (Nemo nga Zvicra: "The Code më ka hapur muzikalisht), 4 maj 2024, Eurovisionworld.com. Për herë të fundit qasur më 19 nëntor 2024. <https://eurovisionworld.com/esc/nemo-from-switzerland-the-code-has-unlocked-me-musically>

Shtatë (7) prej postimeve/përmbajtjeve të analizuar e 58 komente ishin rreth kësaj ngjarjeje. Menjëherë vijoi një kundërshti e madhe ndaj këtij formulimi. Filluan artikujt dhe komentet, që citonin njerëz tek deklaroheshin kundër kësaj nisme, me arsyetimin se kjo nismë po u ndalonte fëmijëve të drejtën ta përdornin fjalën nënë e babë.

Kur është fjala për njerëzit LGBTQ+, u komentua e u cituan njerëz që thonin se kjo nismë ishte në vazhden e përpjekjeve për kalim të draft-Kodit Civil, se kjo nismë shkatërronte familjen dhe krijonte hapësirë për familje jo-heteroseksuale, apo se kjo nismë ishte edhe në kuadër të përpjekjeve për Ligjin për shëndet riprodhues, që po ashtu ishte promovuar nga një numër politikanësh/esh si ligj që promovon familje të degjeneruar, ku nuk dihet kush është babai.

IV.V HOMOTRANSFOBI PËR SHKAK TË DEKLARATAVE, DUKJES, ZGJEDHJEVE E KARAKTERISTIKAVE TJERA

Çështje të tjera (rreth 100 postime) ku u shpërfaq homotransfobi ishin më sporadike, pra çështje që morën vëmendje në një ditë të caktuar, por jo domosdo ishin çështje që vazhduan të zini vend në diskutim publik. Anipse më sporadike, postimet/komentet në to ishin po aq të rëndësishme në hulumtim, të gjitha bashkë mblodhën mbi 10,000 komente, pasi kontribuojnë në të kuptuarit rreth prirjeve të përgjithshme në diskursin publik kur bëhet fjalë për personat/të drejtat/çështjet LGBTQ+.

Për shembull, në disa lajme/postime rreth rritjes së numrit të shkurorëzimeve në Kosovë, nëpër komente, ndër tjera u fajësuan njerëzit LGBTQ+ dhe ato që u quajtën “ligje LGBTQ+” — me shumë gjasë referuar Kodit Civil të pamiruar dhe Ligjit për shëndet riprodhues dhe fertilizim të asistuar; në disa raste të aktivizmit feminist, gratë e angazhuara/përfshira, ndër tjera, u quajtën “lezbike” në përpjekje për t’i ofenduar ato dhe për ta zvogëluar rëndësinë e aktivizmit të tyre; në disa raste/postime kur burra paraqiteshin në profesione që shpeshherë konsiderohen si profesione të përshtatshme për gra, p.sh. si frizerë, ata u ofenduan me terma përcmues, që rëndom përdoren kundër njerëzve LGBTQ+; kur kishte kryesisht ndonjë burrë që njihej në publik si i sjellshëm, i qetë, apo që përkujdesej për mënyrën e veshjes apo stilin e flokëve, edhe ai ofendohej me terma përcmues e urryes kundër njerëzve LGBTQ+. Postimet e mësipërme ishin të ngjashme nëpër të gjitha portalet e analizuara, po aq sa ishin të ngjashme komentet në to.

V.PËRFUNDIM

Gjuha e urrejtjes ka gjetur një vend të përshtatshëm në rrjete sociale, gjegjësisht seksionet e komenteve të portaleve të lexuara, e në fakt, të shumë portaleve mosvarësisht lexueshmërisë së tyre.

Çështja e draft-Kodit Civil ka qenë në mënyrë të vazhdueshme pjesë e raportimit mediatik, po aq sa ka qenë çështje ndaj së cilës është shpërfaqur transhomofobi, urrejtje e gjuhë përjashtuese e ofenduese ndaj njerëzve LGBTIQ+. Këtu kanë kontribuar sidomos politikanët dhe politikanet, që i kanë prirë formësimin të njëfarë narrative se projekt-Kodi Civil njih martsat midis personave të sekseve të njëjta; shkatërron familjen e edhe mundëson bartjen e sëmundjeve. Kjo çështje përmbante nivel të lartë të dezinformative, e edhe të urrejtjes, kryesisht të iniciuar apo legjitimuar nga figura politike dhe figura tjera publike.

Mbulimi mediatik nuk ishte konsistent kur bëhej fjalë për të drejtat LGBTIQ+. Kishte kryesisht përmbajtje sipërfaqësore, që përqendroheshin në ditë të veçanta, lajme të shkurtra që kryesisht citonin figura të ndryshme politike, por rrallëherë personat LGBTIQ+ ishin në qendër të rrëfimitarisë. Nuk u kap mundësia që të shkruhet, raportohet për mirëqenien e njerëzve LGBTIQ+ si qytetarë të Kosovës; për shtypjen sistematike e sistematike që ata/o e përjetojnë e për zgjidhje që do ta reduktonin këtë shtypje. Kësisoj, institucionet përgjegjëse për t'u siguruar njerëzve LGBTIQ+ qasje në drejtësi e barazi nuk u mbajtën llogaridhënëse e përgjegjëse për mosveprimin e tyre.

Po ashtu, mbulimi i të drejtave LGBTIQ+ u përqendrua me të madhe në një ditë të vetme — Paradën e Krenarisë, teksa përkundër këtij përqendrimi, raportimi prapëseprapë nuk shkonte përtej lajmeve dy-tri fjalish të gjata, apo dy-tre paragrafësh të gjata, fotografive apo videove të shkurtëra, të cilat më shpesh raportonin se kush ka dalë në paradë sesa, për shembull, se përse ishte zgjedhur togfjalëshi i sivjetëm i Paradës, çfarë aktivitetelesh u realizuan në kuadër të Javës së Krenarisë, si ishte gjendja e njerëzve LGBTIQ+, cila është historia e organizimit të Paradave.

Të drejtat e personave trans u shpërfillën në raportimin mediatik. U përdor panevojshëm dhe pajustificueshëm fjala "transgjimore". Po ashtu, nuk u respektuan përemrat e njerëzve dhe u krijua hapësirë për përdorimin e emrave të vdekur – emrave që u janë caktuar në lindje, por me të cilët nuk identifikohen më njerëz të caktuar. Edhe komentet, sidomos në postimet që lidheshin me të drejtat trans ishin prej më të shumtave e prej më të rëndave.

Komentet me gjuhë të urrejtjes u lejuan, duke shpërfaqur ose një moskokëçarje për ndikimin që kjo gjuhë e ka te personat LGBTIQ+, ose një dëshirë për të tërhequr komente, pëlqime dhe angazhime në postime në kurriz të personave LGBTIQ+.

Cilado të kenë qenë arsytet, interneti në Kosovë gjatë vitit 2024 ishte armiqësor ndaj njerëzve LGBTIQ+, duke na vënë përpara një rrugë të gjatë të punës, vetëkritikës dhe angazhimit të njëmendtë e aktiv kundër kësaj gjuhe dhe kundër çdo përmbajtjeje që fton për këtë gjuhë.

V.I NË VEND TË REKOMANDIMEVE

V.I.I PËR MEDIET DHE GAZETARËT/ET E HAPUR/A PËR NDRYSHIM

- Gazetarët/et, të kontaktojnë organizata jo-qeveritare që punojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave LGBTIQ+ për këshillim kurdo që nuk janë të sigurt/a nëse terminologjia që po përdorin është e saktë;
- Ata/ato mund të krijojnë raporte miqësore me OJQ, që punojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave LGBTIQ+ dhe të kërkojnë këshilla, sugjerime, rekomandime për përmbajtje që lidhen me të drejtat dhe njerëzit LGBTIQ+;
- Ata/ato mund të aplikojnë në mënyrë aktive në nismat, trajnimet, punëtoritë e ofruara në vend dhe jashtë tij rreth të drejtave të njeriut dhe rreth praktikave të mira të raportimit për të drejtat e njeriut;
- Entitetet mediale mund të bashkëpunojnë me OJQ, që së bashku të identifikojnë njerëz LGBTIQ+ që do të mund të ndanin rrëfimet e përvojat e tyre, ashtu që prania e rrëfimeve LGBTIQ+ të shtohet;
- Entitetet mediale mund të angazhojnë dikë nga jashtë (ekspertë/e, aktivistë/e, redaktorë/e, gazetarë/e) apo mund të krijojnë ekipe përbrenda redaksive të tyre që krijojnë/përkthejnë udhëzues, politika redaktoriale apo protokole, që sigurojnë gjithëpërfshirjen në përmbajtjet e prodhuara. Nëse u duhen këshilla, sugjerime shtesë, ata/o udhëzues mund t'i ndajnë me mediet që kanë ekspertizë në mbulimin e të drejtave të njeriut apo OJQ që punojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut;
- Entitetet mediale mund të konsultojnë doracakë që veç ekzistojnë për mënyrën e raportimit të ndjeshëm në fushën e të drejtave të njeriut. Një doracak i tillë është prodhuar nga revista online Kosovo 2.0 në vitin 2024 dhe është i qasshëm për redaksitë. Po ashtu, një doracak është prodhuar nga vetë CEL. Doracakë të ngjashëm e të besueshëm ekzistojnë në internet — të prodhuar nga medie e OJQ të ndryshme. Mediet mund t'i shqyrtojnë këta doracakë e t'i shfrytëzojnë sipas nevojave të tyre;
- Entitetet mediale mund të vendosin klauzolë të qartë rreth komenteve të papranuara dhe të caktojnë ekipe për t'i moderuar komentet përkitazi me parimet;

- Entitetet mediale, nëse nuk kanë kapacitete njerëzore të moderojnë komentet, mund të bllokojnë përkohësisht seksionet e komenteve;
- Mund t'i shmangen citimeve të figurave që kanë dëshmuar se janë armiqësore e mospranues ndaj njerëzve LGBTIQ+;
- Nëse vendosin të përfshijnë figura që kanë dëshmuar se janë armiqësore e mospranues ndaj njerëzve LGBTIQ+ në përmbajtjet e tyre, të ofrojnë kontekst, shpjegim dhe sqarime shtesë dhe të arsyetojnë se përse ai citim është i nevojshëm;
- Nëse vendosin të ftojnë njerëz LGBTIQ+ për intervista, debate e diskutime, të mos i vendosin ata/o përballë figurave që kanë qenë historikisht armiqësore ndaj njerëzve LGBTIQ+. Entitetet mediale janë përgjegjëse për t'u krijuar njerëzve LGBTIQ+ një ambient të sigurt, të drejtë dhe të rehatshëm ku ata/o mund t'i ndajnë rrëfimet e tyre të papenguar. Mediet duhet të marrin përbazë shtypjen e kahmotshme kundër njerëzve LGBTIQ+ dhe të sigurohen që ato nuk e riprodhojnë këtë shtypje, me apo pa qëllim;
- Entitetet mediale duhet të bëjnë më shumë hulumtime kur raportojnë për njerëz përgjithësisht, por sidomos për njerëz që kanë folur publikisht për orientimin seksual të tyre e identitetin e tyre gjinor ashtu që të sigurohen t'i përdorin përemrat e duhur dhe mënyrat e duhura të prezantimit;
- Entitetet mediale duhet të jenë më të qëllimshme në përfshirjen e rrëfimitarisë LGBTIQ+ në të menduarit e tyre redaktorial dhe duhet të investohen që gazetaria e tyre t'u shërbejë të gjithëve/ave barabartë.

V.I.II PËR MEKANIZMAT RREGULLUES DHE VETËRREGULLUES TË MEDIEVE

- Të organizohen më shumë trajnime, kampanja — gjithnjë sipas nevojave të entiteteve mediale — rreth raportimit të ndjeshëm kur është fjala për të drejtat LGBTIQ+;
- Të krijohen më shumë mjete, udhërrëfyes, burime për mediet se si të trajtojnë të drejtat e njeriut, me vëmendje në të drejtat LGBTIQ+ në mënyrë të saktë, drejtë e ndjeshme;
- Të krijojnë dhe mirëmbajnë komunikim të afërt me OJQ që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut, ashtu që të mbahen të përditësuar/a rreth praktikave të fundit të raportimit të ndjeshëm e të drejtë kur është fjala për të drejtat e njerëzit LGBTIQ+.

V.I.III PËR KOMUNITETIN E DONATORËVE

- Të investohet më shumë e më qëllimshëm në bashkëpunimet midis OJQ që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut dhe entiteteve mediale;
- Të investohet në ofrimin e mbështetjes për entitetet mediale që të krijojnë mekanizma të brendshëm, protokolle, politika redaktoriale që sigurojnë mbulim të saktë, të drejtë e gjithëpërfshirës të çështjeve që lidhen me të drejtat e njerëzit LGBTIQ+;
- Të investohet në qëndrueshmërinë institucionale të medieve që kanë demonstruar standard të lartë profesional në raportimin e saktë, të drejtë e gjithëpërfshirës të çështjeve që lidhen me të drejtat dhe njerëzit LGBTIQ+;
- Të investohet në qëndrueshmërinë institucionale të OJQ që punojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njerëzve LGBTIQ+; rrjedhimisht të mbështes hulumtim të vazhdueshëm dhe kapacitetet e këtyre organizatave që të kundërshtojnë urrejtjen, t'u ofrojnë njerëzve LGBTIQ+ mbështetjen që u duhet.

